



PROCESVERBALI

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **28.06.2018** me fillim në ora **10.15**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. **Afrim Dina**. Konstatohet se kuorum, për mbajtjen e mbledhjes kemi, **Kryesuesi** – Fillimisht më lejoni të përshëndes Nënkryetarin e Komunës z. Fatmir Iska, përfaqësuesit e LMT-së, monitoruesit e SHL-Kosova, përfaqësuesit e mediave, Drejtorët e Drejtorive Komunale, delegatët e Kuvendit Komunal dhe gjithë të pranishmit. Besoj se rendin e ditës dhe materialin e keni marrë me kohë? Për këtë mbledhje propozoj këtë:



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



REND DITE

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

1. Aprovimi i Procesverbalit nga Mbledhja e Kaluar, -III- Nr. I prot. **2210** Më **26.07.2018**
Br. prot. **2210** Dt. **26.07.2018**
RAHOVEC - ORAHOVAC
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve,
3. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Rahovecit 2019 – 2021,
4. Shqyrtimi i Planit të Veprimit Komunal Kundër Korrupsionit,
5. Shqyrtimi i Raportit të Performancës Komunale,
6. Shqyrtimi i propozim Vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm pjesën e parcelës P-71513005-00524-4, në fshatin Krushë e Madhe,
7. Shqyrtimi i propozim Vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm pjesën e parcelës P-71510056-00034-0, në fshatin Opterushë,
8. Shqyrtimi i propozim Vendimit për formimin e Komisionit për zgjedhjen e Këshillave Lokalë,
9. Shqyrtimi i propozim vendimit për ndihmë financiare z. Bajram Popaj.

Pika shtesë

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm të parcelës P – 71510057-02240-1.
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm të parcelës P – 71510057-02247-0.
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit për aprovimin e listës së anëtarëve të zgjedhur të Këshillit të Fshatit Hoçë e Madhe.

Kryesuesi – Të nderuar kuvendar për këtë mbledhje të rendit të ditës kemi edhe 3 pika shtesë, a jeni të pajtimit që këto pika shtesë të jenë pjesë e rendit të ditës, pasi janë me urgjencë.

Rasim Fazliu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, falënderoj kryesuesin për prezantim të rendit të ditës, por kishte me qenë mirë që në mbledhjet e radhës të mos bëhet praktik shtimi i pikave të rendit të ditës, por të

gjitha pikët që do të diskutohen në mbledhje të na vinë me kohë. Por duke u bazuar në atë që janë pika emergjente kësaj radhe ne si grupe i PDK-së jemi pro që të kalojnë këto 3 pika.

Kryesuesi – E qes në votim rendin e ditës me tri (3) pika shtesë: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga Mbledhja e Kaluar.

A ka dikush të shtoj diçka sa i përket pikës së parë, nëse jo e qes në votim Procesverbalit nga Mbledhja e Kaluar: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e parë (1) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve.

Afrim Berisha – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kam një kërkesë sa i përket ngrohjes së shkollave tona gjatë stinës së dimrit, lëndët djegëse vinë me vonesë, mendoj se lëndët djegëse duhet që të vinë në kohën më adekuate. Kjo është edhe kërkesë e punëtorëve teknik të shkollave të cilët janë duke kërkuar që kjo praktik të harrohet dhe sjellja me kohë e lëndëve djegëse në shkolla ja lehtëson punën edhe atyre.

Rasim Fazliu – I nderuari Kryesues kam një sugjerim sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, mendoj që është më mirë, po ashtu është rregull që së pari ekzekutivi të i përgjigjet pyetjeve nga mbledhja e kaluar, e pastaj ne kuvendarët të parashtrojnë pyetje për këtë mbledhje.

Kryesuesi – Besoj se drejtorët e drejtorive janë përgjigjur në pyetjet që ju janë drejtuar atyre në mbledhjen e kaluar, nëse jo atëherë munden tani të ju përgjigjen.

Nënkryetari - Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sa i takon kërkesës së kuvendarit z. Rasim Fazliu, sipas procesverbalit nga mbledhja e kaluar ne ju jemi përgjigjur të gjitha pyetjeve, por nëse ka ndonjë pyetje që nuk ju kemi përgjigjur drejtorët janë këtu dhe munden të i përgjigjen.

Fehmi Cena – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha që ti ngrisë dy çështje të vogla, e parë shkon për Kryetarin. Të hënën e kaluar ne e kemi mbajtur një mbledhje emergjente që është dedikuar dëmeve të shkaktuara në bujqësi fermerëve tanë nga reshjet dhe breshëri, po ashtu edhe nga vërshimet, në këtë mbledhje na janë prezantuar dy dokumente me shkrimë, vendimi për ndarje të mjeteve me shumën prej 7,000.00 €, dhe dokumenti i dytë ka qenë deklarata ku janë paraqitur disa rekomandime drejtuar qeverisë së Kosovës për të kërkuar ndihmë konkrete për fermerët e dëmtuar. Një ditë më vonë në Komunën tonë ka ardhur Ministri i Bujqësisë dhe pyetje ime është: A është biseduar konkretisht për këtë çështje dhe nëse po a ka diçka konkrete në këtë drejtim, shpresojmë që mos të mbetet vetëm si diskutim dhe vetëm si letër. Çështja e dytë po ashtu ka të bëjë me fermerë dhe vreshtarë, tani është faza kur fillon spërkatja me produkte bujqësore, bujqit ankohen se në barnatoret bujqësore të Komunës sonë ka produkte bujqësore me afat të skaduar me vite të tëra, ka pasur raste që bujqit dhe fermerët tanë janë dëmtuar nga kjo. Kjo çështje besoj se i takon Drejtorisë së Inspektoratit dhe ata janë kompetent që të i bëjnë kontrollet e duhura, nuk e di dhe nuk jam në dijeni se a i bëjnë këta kontrollet këtyre barnatoreve bujqësore, nëse jo mendoj se duhet që kjo të jetë prioritet.

Rexhep Oruçi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, po e potencoj një çështje e cila është dashur që në njërin nga mbledhjet e ardhshme të jetë në rend të ditës, fjala është për Ridefinimin e Monumentin Natyrorë të Kanionit të Lumit Drini i Bardhë. Kjo çështje është shqyrtuar edhe në vitin 2016 -2017, ku kanë punuar ekspertë dhe grupe të ndryshëm nga ministrinë përkatëse, janë bërë elaborate dhe propozime konkrete rreth ridefinimit të kësaj sipërfaqe të tokës sepse rrethanat dhe gjendja aktuale ka ndryshime. Ende është në fuqi vendimi i Kuvendit i vitit 1985, kurse që nga ajo kohë shumë gjëra kanë ndryshuar. Elaboratet dhe propozimet konkrete janë gati, në vitin 2017 Kuvendi e ka shqyrtuar këtë çështje, por arsyeja pse ka mbetur ka qenë se ishin afër fushatat zgjedhore dhe anëtarët e Kuvendit kanë insistuar që kjo çështje të zgjidhet pas zgjedhjeve Komunale. Prandaj mendoj dhe propozoj që kjo çështje të futet në rend dite në njërin nga mbledhjet e ardhshme në mënyrë që kjo të kryhet.

Florije Boshnjaku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, do e ngrisë një shqetësim i cili i shqetëson qytetarët e Komunës sonë, ka të bëjë me barnat esenciale, e di që është problem sepse edhe unë kam qenë drejtorësh e shëndetësisë. Shqetësimi imë dhe i qytetarëve ka të bëjë me mungesë të insulinës në Komunën tonë, a ka mundësi që me e paraqit një kërkesë në Ministrinë e Shëndetësisë që të ritën këto insulina, ose a ka ndonjë plan

konkret Ministria e Shëndetësisë lidhur me barnat esenciale sepse shumë më mirë kishte me qenë nëse i ndahet buxhet Komunave për barna esenciale dhe Komuna me menaxhu me atë buxhet për barna esenciale.

Florida Bajraktari – Përshëndetje për të gjithë, do të kërkoja nga ekzekutivi ose nga drejtoria përkatëse që të dele në teren që ti inspektojë vendet ku mungojnë emërtimet e fshatrave, pra të dihet se ku fillon dhe ku mbaron një fshat. Pyetje e dytë shkon për Drejtorin e Inspektoratit, kishte me qenë mirë që ti kontrollojnë dyqanet e vogla ushqimore sepse janë duke mbajtur produkte me afat të skaduar.

Ali Morina – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, po ashtu edhe unë desha të shtjellojë diskutimin sa i përket tabelave informuese për drejtimin e rrugëve të fshatrave, pra të na orientojë se ku ndahen rrugët, mungesë të tabelave informuese ka si në Fortesë, Vrajak, Guri Kuq, Polluzh, pra kishte me qenë mirë që të kemi një sinjalizim më të saktë. Po ashtu kam një pyetje për Drejtorin e Urbanizmit, emërimi i rrugëve ka filluar sa e di në vitin 2013 dhe pothuajse ky proces ka përfunduar në të gjitha Komunat e Republikës së Kosovës, ndërsa Komuna jonë ende ka ngelur mbrapa në këtë proces. Prandaj pyetje ime për drejtorin është ku jemi ne me këtë proces dhe kur pritet të përfundoj emërtimi i rrugëve dhe lagjeve urbane.

Qazim Qeska – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Në Mbledhjen e kaluar kam kërkuar një informatë nga Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm, e falënderoj drejtorin i cili më ka kthyer përgjigjen në formë të shkruar në hollësi dhe përpikëri, por do të kërkoja si përfaqësues i qytetarëve të lagjes që e gravitojnë në projektin që ishte pjesë e pyetjes, institucionet Komunale është mirë që të merë masa ndaj operatorit konformë ligjit sepse në informatë në mënyrë të qartë është cekur se operatori nuk e ka kryer punën konform kontratës. Lidhur me këtë projekt kam biseduar me qytetarët të cilët jetojnë në këtë lagje dhe sipas tyre rrugët dhe rrugicat janë në një gjendje të mjerueshme dhe të pakalueshme, nëse në një kohë të shkurtër nuk merren masa qytetarët edhe përkundër vullnetit tonë do ta iniciojnë procedurën e peticionit për marrjen e masave ligjore kundër operatorit në fjalë, nuk do të dëshirojë që të vije deri tek kjo dhe besoj se Drejtori i Urbanizmit do ti përmbahet obligimeve që i ka marrë sipas kësaj informate.

Faton Ramadani – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, do të diskutoj sa i përket fushë së arsimit, gjatë fushatës publike në media të gjithë kandidatët për Kryetar të Komunës së Rahovecit kanë premtuar se do të hapin sa më shumë çerdhe për fëmijë si në fshatin Krushë e Madhe, Xërxë dhe Ratkoc. Po ashtu edhe unë jam i mendimit që është shumë e nevojshme hapja e këtyre çerdheve sa më shumë që është e mundur. Pyetje ime për Kryetarin dhe Drejtorin e DKA-së: Kur do të fillojnë të hapen këto çerdhe.

Vahid Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, i kam dy pyetje, njëra është për një shqetësim të qytetarëve pasi që sipas tyre së paku tri herë kanë bërë ankesa në polici për rrugën lokale Rahovec – Drenoc. Në këtë rrugë është një shtëpi private e bardhë, kafshët shtëpiake në këtë rast qentë 24 orë në ditë i ke në mesin e rrugës dhe ky është një rrezik për nxënësit që udhëtojnë nga fshati Drenoc, Senoc, Pastasel, Potočan për në Rahovec dhe anasjelltas, kishte me qenë mirë që Komuna të ndërmerr diçka në mënyrë që të evitohet ndonjë konflikt në mes qytetarëve. Pyetja e dytë shkon për Drejtorin e Rinisë, kulturës dhe sportit, meqenëse salla e sportit është duke u ndërtuar por nuk e di se kur do të përfundoj, por e pyes drejtorin a e ka pa të arsyeshëm që të inicioj hapjen e një klubi të futsalit pasi që jam pjesë e reprezentacionit të Kosovës në këtë sport, prandaj dëshira ime gjithmonë ka qenë që Komuna jonë ta ketë këtë klub, pasi që këtë lloj sporti gjithmonë e ka praktikuar dhe ka qenë shumë i popullarizuar me këtë futboll të vogël.

Refki Kryeziu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, është një kërkesë nga prindërit e shkollës fillore në fshatin Xërxë që objekti i cili gjendet përballë shkollës fillore “Hamëz Thaqi” që dikur e ka ushtruar punën PTK-ja tani është komplet i demoluar, tani në këtë objekt ushtrohen veprimtari negative, prandaj kërkesa e tyre është që mundësisht Komuna të merë masa dhe të kontaktojë me përgjegjësit e PTK-së dhe të mirën masa që ky objekt të largohet nga ky vend.

Ali Zhuniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Desha të ndërlidhem sa i përket Komisionit i cili ka qenë aktivë në teren gjatë gjithë javës lidhur me vlerësimin e dëmeve që janë shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore, pyetje ime për Kryetarin është: A kanë qenë që të katërt anëtar të komisionit inxhinier të bujqësisë dhe a është bërë vlerësimi i dëmeve në bazë të përqindje, pastaj a kanë qenë anëtar të komisionit të duhur për vlerësimin e asaj fushe. Kam parë që bashkëfshatarët kanë pasur bukur shqetësime sa i përket vlerësimit të dëmeve duke krijuar

edhe mosmarrëveshje me anëtarët e komisionit, prandaj kisha kërkuar nga ekzekutivi që së paku të jenë në kontakt të vazhdueshëm me këtë komision që ti kërkojnë që ta kryejnë punën e vetë në mënyrë të duhur dhe vlerësimi të kryhet në mënyrë adekuate. Mirë që është bërë vlerësimi i dëmeve por mendoj se në një shtet normalë Ministria e Bujqësisë është dashur që të merret ekskluzivisht me vlerësimin e këtyre dëmeve, pastaj është dashur të dërgojë së paku tre inxhinier të bujqësisë dhe të i bashkëngjiten këtij komisioni komunal. Pyetje ime direkt shkon për Kryetarin dhe Drejtorin e Bujqësisë: A ka diçka konkrete sa i përket ndihmës që keni kërkuar nga Ministria e Bujqësisë, apo këto janë thjeshtë reklamacione që vazhdimisht ju i bëni për facebook, kurse në esencë nuk ka asgjë pos reklamës, e them këtë sepse njëra nga qeveritë e kaluar ka premtuar se do të ofrojë 60.00 € për hektar, duke e pasur parasysh investimet dhe kthimin e ndihmave apo subvencioneve në esencë paraqet as shumë simbolike.

Rasim Fazliu – I kam dy pyetje por që të dyja munden të ngërthehen ë një pyetje, prioriteti i kësaj qeverie dhe qeverive të tjera ka qenë uji i pijes dhe ujërat e zeza, pyetje ime është: Sa është duke punuar në këtë drejtim drejtoria përkatëse dhe ku është duke punuar, flasë duke u bazuar nga vendi unë ku vijë por edhe nga vendet e tjera. Ka shumë lagje që nuk janë fare të përfshirë në rrjetin e kanalizimit dhe ky është një shqetësim shumë i madhe për këta banorë, konkretisht është lagja Dina tek shkolla, lagja Ramadani, Abazi dhe disa lagje të tjera. Kishte me qenë shumë mirë nëse brenda mundësive buxhetore sa janë të parapara për zgjerimin e rrjetit të kanalizimit të investohet në këto projekt.

Munib Durguti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të ngrisë një çështje e cila ka qenë në diskutim e sipër në fund të mandatit të kaluar, ka të bëjë me Planin Mobilitetit i cili është hartuar në bashkëpunim me DEMOSIN, rënga ime qëndron për dy rrugë të qytetit, njëra rrugë është “Gëzim Hamza” segmenti nga shkolla “Xhelal Hajda- Toni” e deri tek podrumi i vjetër dhe rruga tjetër është ish rruga 28 nëntori tani e quajtur

“Ibrahim Rugova” nga parku i qytetit e deri tek ura ose rruga e re që është hapur pranë shkollës “Xhelal Hajda – Toni”. Në këto dy rrugë janë hapur shumë hoteleri dhe banorët e lagjeve janë totalisht të bllokuar në qarkullim, gjithmonë njëra rrugë është e bllokuar me makina të parkuara me qëllim që të pina kafe në këto lokale, ajo që më intereson mua është të më tregoj Drejtori i Shërbimeve Publike, a kemi diçka sa i përket këtij plani dhe a parashihet diçka sa i përket këtyre dy rrugëve, a do të jenë një drejtimesh ose diçka të ngjashme.

Mirjeta Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të diskutoj rreth arsimit në Komunën tonë, a ka ndonjë mundësi që të punësohen dy psikolog dhe dy pedagog në nivel Komune dhe pastaj këta pedagog dhe psikolog të kryejnë punën në të gjitha shkollat e Komunës së Rahovecit. Në shkollat tona është shumë e nevojshme prania e tyre sepse do të zgjidheshin shumë probleme me nxënës hipëraktiv, mundësisht të futen këta të gjendet një mënyrë ose me DEMOSIN ose në ndonjë formë tjetër por të jenë të pranishëm.

Besmira Bytyqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, pyetje ime shkon për Drejtorin e Shërbimeve Publike, në mes të një rruge në fshatin Apterush është e vendosur një shtyllë elektrike, ku së fundi ka ardhur edhe deri tek një aksident shkaku i kësaj shtylle, por për fatë të mirë ka kaluar vetëm në dëme materiale. I bëj thirrje drejtorisë përkatëse që sa më parë të mirët me eliminimin e këtij problemi.

Nënkryetari – Do mundohem të i përgjigjem pyetjeve të cilat jam i informuar dhe për të cilat kam përgjigje, kurse për pyetjet e tjera janë drejtorët prezent do ju përgjigjen. Kuvendari z. Afrim Berisha e kishte pyetjen rreth vonësive të lëndës djegëse në shkolla, sa për informatë i nderuar është filluar procedura e shpalljes së tenderit për lëndë djegëse në shkolla dhe besoj se do të jemi në afat sa i takon furnizimit me lëndë djegëse në shkolla. I nderuar z. Fehmi Cena është e vërtetë se jemi takuar me ku kemi biseduar sa i takon kësaj situatë emergjente po ashtu kemi aprovuar një deklaratë, ne po ashtu edhe në takim me Ministrin e Bujqësisë, kemi diskutuar sa i takon dëmeve në bujqësi, bujqësi, amvisëri, pastaj dëme në hapësira publike sa i takon kanalizimeve parqeve etj. po ashtu kemi marrë premtim nga ministri, ne nuk bëjmë fushat siç e tha z. Ali Zhuniqi, por en tregojmë atë çka kemi biseduar me ministrin përkatëse për ti dalë në ndihmë bujqve të Komunës sonë sepse këto janë premtime që jepen nga Qeveria e Kosovës dhe ne të gjithë që jemi këtu e dimë se sa ka fuqi Komuna të i dele në ndihmë bujqve sa i takon kompensimit të dëmeve sepse dëmi është goxha i madhe, vetëm në vreshta e kalon shifrën 1 minoheshe. Premtimi i ministrit ka qenë që ne pasi të përfundojmë vlerësimin e dëmeve në bujqësi, po ashtu ka qenë pjesëmarrës edhe komisioni i cili është i përhershëm në kuadër të ministrisë së bujqësisë për vlerësim të

dëmeve, por anëtarët e komisionit qeveritar marrin pjesë në 3-4 raste e jo në të gjitha rastet, pasi të përfundojë punën komisioni për vlerësim të dëmeve atëherë do të bëhet raporti ku do ti dorëzohet Ministrisë së Bujqësisë dhe Qeverisë së Kosovës dhe pastaj besoj se kjo do të bisedohet në mbledhje të Qeverisë së Kosovës për ndarjen e një fondi emergjent, sa do të jetë ky fond për Komunën tonë për kompensim të dëmeve nga Qeveria e Kosovës, por ajo mbetet nga Qeveria e jo nga ne. Kuvendari Rexhep Oruçi pyeti sa i përket ridefinimit të monumentit të Gradishit tek Drini i Bardhë, konkretisht mbrojtja e zonës rreth kanionit të urës së Shejtë, është e vërtetë se është marrë një vendim në vitin 1986 për mbrojtjen e kësaj zone, po ashtu është diskutuar në vitin 2016, po ashtu edhe në vitin 2017 por në këtë kohë ishte fushata zgjedhore dhe është shtyrë pas zgjedhjeve. Mendoj se njëherë duhet që të diskutohet në vendbanimet ku është ajo zonë, duke e përfshirë banorët e Xërxës, Gexhes, pastaj ne si qeveri Komunale së bashku me Kuvendin Komunal mundemi që të diskutojmë dhe të marrim vendime të mëtutjeshme. Znj. Florida Bajraktari pyeti rreth mungesës së shenjave për emërtim të fshatrave, e nderuar është e vërtetë se mungojnë disa shenja, por besoj se po të ishim ne pak më të vetëdijshëm dhe më të kujdesshëm nuk e besoj se kishin për të munguar shenjat, por sidoqoftë ne do të përpigemi përmes Drejtorisë së Shërbimeve Publike që ti vendosim këto shenja në ato vende ku mungojnë edhe pse këto shenja kanë një kosto bukur të madhe. Pastaj sa i takon inspektimit të dyqaneve të vogla ushqimore edhe unë gjithsesi pajtohem që të inspektohen këto dyqane në mënyrë që vazhdueshme sepse aty mundemi të gjejmë mallra me afat të skaduar, ne do të kujdesemi që të shtohet ky volum i punës sa i takon inspektimit. Pastaj z. Ali Morina e kishte pyetjen e njëjtë sa i takon emërimit të fshatrave dhe rrugëve, ku e përmendi se në të gjitha Komunitat ka përfunduar procesi kurse në Komunën tonë ende nuk ka përfunduar. I nderuar është e kundërta nga ajo që ju e thatë sepse Kuvendi Komunal në vitin 2016 e ka përmbyllë këtë punë sa i takon emërimit të rrugëve, rrugicave dhe shesheve, kam qenë njëri nga anëtarët e komisionit dhe po ju them se komisioni e ka bërë punën aq sa ka mundur në bashkëpunim me çdo këshill të fshatit, tani a ka probleme dhe ankesa kjo besoj se është normale, kryesuesi i Kuvendit e ka një raport të ankesave. Por ajo që është më e rëndësishme është se propozimet kanë ardhur nga çdo vendbanim, përpos qytetit i cili ka pasur emetimin e rrugëve më herët. Ne mundemi me kontakti me Agjensionin Kadatral dhe Ministrinë e Planifikimit Hapësinorë në rast se paraqitet ndonjë problem i madhe sa i takon emërimit të rrugëve, ky vendim normalë që mundet të ndryshohet sepse nuk është vendim që definitivisht nuk mundet të ndryshohet. Pra Komuna e Rahovecit e ka përmbyllur me suksese punën emërimit të rrugëve dhe rrugicave. Z. Faton Ramadani është e vërtetë që është premtuar ndërtimi i çerdheve, por ne jemi në gjysmën e parë të këtij viti dhe punojmë me buxhetin i cili është miratuar vitin e kaluar, por sidoqoftë ne do të kujdesemi për ngritjen e çerdheve të reja në atë vende ku është e nevojshme. Në ato vendbanime që janë afër njëra me tjetrën si p.sh Krusha e Madhe me Celinë, Nagavc, këtu mundemi të ndërtojmë ë një çerdhe në Krushë të Madhe, kështu me radhë. Z. Refki Kryeziu është e vërtetë ajo që ju e thatë dhe qëndron ky shqetësim, do të kontaktojmë me personat përgjegjës të PTK-së dega në Rahovec dhe do të shikojmë se çka mundemi me bë rreth këtij objekti. Sepse ne të gjithë e dimë se çka bëhet në ato objekt që janë gjysmë të demoluar. Në pyetjen e kuvendari z. Ali Zhuniqi besoj se jam përgjigjur sepse pyetje ka qenë pothuajse e njëjtë me atë të z. Fehmi Cena. Por i nderuar anëtar të komisionit kanë qenë njerëz të cilët janë punëtor të Drejtorisë së Bujqësisë dhe janë inxhinierë, pastaj janë ftuar edhe kryetarët e fshatrave që të jenë prezentë në atë vende me komisionin, pra shpresa për kompensim të dëmeve mbetet nga presioni ynë i vazhdueshëm, por po ashtu mbetet tek Qeveria e Kosovës se sa ka fond për ndarje të një fondi emergjent për mbështetje të fermerëve. Znj. Mirjeta Krasniqi po është premtim dhe ne e kemi në fokus punësimin e dy psikologëve dhe dy pedagogëve për shkollat e komunës sonë, ne do të mundohemi që ta risim këtë numër, kemi tentuar edhe përmes një projekti por në mungesë të buxhetit nuk kemi mundur ta kryejmë këtë punë, por ne do të parashohim në buxhetin e vitit 2019, pra prioriteti ynë është që të punësohen psikolog dhe pedagog në shkollat. kjo ishte nga ana ime, kurse për pyetjet e tjera që nuk kam mundur të ju përgjigjem do ju përgjigjen Drejtorët e Drejtorive përkatëse.

Përparim Krasniqi – Përsëritje për të gjithë të pranishmit, znj. Florida dhe z. Ali Morina e kanë pas pyetjen e njëjta sa i përkat tabelave informuese për vendbanime, ne jemi në fazën e kontraktimit të kompanisë për sinjalizim horizontal dhe vertikal, do të shikojmë mundësitë për vende të këtyre tabelle edhe pse këto tabela kanë një kosto bukur të madhe. Z. Vahid Krasniqi sa i përket qebeve endacak për herë të parë të gjitha Komunitat e

Kosovës kanë bërë një marrëveshje me AVUKUN, për eliminimin dhe trajtimin e qeneve endacak, po ashtu do të regjistroheshin edhe ata qen që janë nëpër shtëpi, ne si Komunë jemi përfitues në dy kontrata, bartjen e shpenzimeve do ta bartë AVUKU me kompanitë që janë të licencuara për eliminimin dhe trajtimin e qeneve endacak. Për çdo informatë që keni ju kisha kërkuar që të kontaktoni me Drejtorin Inspektuese sepse është caktuar një person përgjegjës për këtë punë, të i tregoni se ku gjenden qentë që përbëjnë rrezikshmëri të lartë. I nderuari z. Rasim Fazliu është e vërtetë sa i përket çështjes së kanalizimit, ne në fillim të mandatit kemi formuar një komision prej 3 anëtarëve ku i kanë identifikuar diku 15 km që kemi pasur kërkesa për trajtimin e kanalizimeve në të gjitha Komunat, në seancën e prillit kemi kërkuar nga kuvendi që ta aprovoj një buxhet prej 10,000.00 € për përmirësimin e kanalizimeve në të gjithë Komunën për arsye se ne në buxhetin e trashëguar nuk kemi pasur kod buxhetor për këtë çështje. Unë jam në dijeni për fshatin Celinë e di shumë mirë se cilat lagje nuk kanë kanalizime, ne jemi në fazën e përfundimit të projektit, besoj se për një muaj ne e kalojmë këtë proces e pastaj do të trajtojmë me seriozitet. I nderuari z. Munib Durguti ne në mandatin e parë e kemi bërë një regjim të rrugës “Xhelal Hajda – Toni” sepse siç e dini Rahoveci ka probleme sidomos me parkingje, prandaj ne edhe tani mendojmë që ta mbajmë një takim me policinë, me ekspertë të komunikacionit nga ministria dhe me drejtoritë e tjera përkatëse që të shikojmë dhe të zgjidhim problemin e rrugëve të Rahovecit posaçërisht rrugët që ti i ceke më parë. Znj. Bersmire Bytyqi pati pyetje rreth një shtylle në fshatin Apterush, e nderuar këto janë në kompetencë të Kedsit, jam në dijeni me këto probleme sepse kësi probleme nuk i ka vetëm fshat ku edhe unë banoj por janë probleme që i ka secili fshat. Do i drejtohem me një shkresë zyrtare Kedsit për eliminim e këtyre shtyllave që janë të vendosura në rrugë.

Ervin Hoxha – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, i nderuari z. Vahid Krasniqi së pari është një lajmë shumë i mirë për gjithë qytetarët e Komunës së Rahovecit që pas 10 viteve palestra e qytetit këtë vite do ta merë epilogun e saj përfundimtar. Po ashtu në planet tona afatmesme e kemi prioritet krijimin e klubit të futsallit, volejbollit, hendbollit, boksit dhe disa sporte të tjera që i kanë munguar që një kohë të gjatë qytetit të Rahovecit.

Kryesuesi – Ju faleminderit për diskutimin e bërë, kalojmë në pikën e radhës:

3. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Rahovecit 2019 – 2021.

Afrim Limani - Përshëndeti të pranishmit, po ashtu Drejtori Limani prezantoi para Kuvendarëve Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës së Rahovecit për vitin 2019 – 2021, Ku më pas pëson debati me kuvendarë.

Fahrije Lushi Morina – Përshëndetje për të gjithë, meqë për bujqësi u fol shumë deri më tani dhe pasi brenda kësaj kornize afatmesme buxhetore një vend të rëndësishëm zë edhe bujqësia, por nuk do të ndalem në bujqësi sepse u fol shumë, do të ndërlihem sa i përket arsimit sepse është një nga prioritetet i cili është i vendosur tek kjo kornizë, për deri sa keni vendosur që të ndërtoni objekte të shkollave të reja, mendoj se kishte me qenë më mirë që në vend të tyre të ndërtoni kopshte për fëmijë. Konsideroj se objektet shkollore janë të mjaftueshme por kishte me qenë mirë që ato ekzistuese të rinovohen në mënyrë që ti plotësojnë kushtet në parim në mënyrë që ti quajmë shkolla sepse në disa shkolla janë kushtet shumë të dobëta, ose i mungon faktori kryesor siç është higjiena pa të cilën nuk mundet të ketë zhvillim normal të jetës e lëre më të mësimi. Këtë informacion e kishim edhe nga Drejtori i DKA-së të cilin e patëm vlerësuar dhe mbështetur, por mendoj se duhet mbështetur edhe ndonjë fakt nga periudha 6 mujore e këtij viti dhe të shikohet se çka është punuar në këtë drejtim. Tek Drejtoria për Rini, Kulturë dhe Sport, të gjitha pikat janë për tu përgëzuar nga të gjithë por ajo që mua më bëjnë përshtypje janë dy pikat që lidhen me intervenimin në monumente kulturo – historike dhe mirëmbajtja e tyre, si dhe pasurimi i fondit librar në bibliotekat e Komunës sonë që të dyja janë në favor të gjithë neve. Pastaj pika e gjashtë është krijimi i qeverisë Komunale e cila ofron shërbime efikase për të gjithë qytetarët. Mendoj se për këtë pikë na duhet kohë e gjatë për të vlerësuar këto prioritetet sepse mendoj se edhe ne do të posedojmë fakte më tepër, kurse nga ana e juaj presim që të na argumentoni më tepër me punë në mënyrë që të arrihet ai konsistimi i prioritetëve që keni vendosur brenda kësaj kornize. Në këtë pikë keni vendosur një mori prioritetesh që më të vërtetë janë më se të pranueshme dhe të mirëseardhura.

Rasim Fazliu – Falënderoj Drejtorin e Financave që na ka ofruar këtë KAB-in për vitin 2019 -2021, ne e kemi shqyrtuar edhe në KPF ku i kemi shprehur mendimet tona, do mundohemi që të japim edhe një kontribut tani sa i përket KAB-it. Në fillim ku ceket Strategjia zhvillimore komunale deklarata me prioritet afatmesëm në faqe nr.3,

ka pasur vërejtje se sa vendbanime janë në Komunën e Rahovecit, po ashtu ne po kemi probleme me termin vendbanim, vendbanim unë e kuptoj se është janë edhe fshatrat edhe qytetit, pastaj aty ku janë të cekur 2 vendbanime duhet të përmirësohet dhe të bëhet 3 vendbanime sepse aty janë. Pastaj mirë që janë cekur në këtë strategji prioritetet që do të jepen në të gjitha fushat, shpresojmë se do të kemi mundësi buxhetore që të realizojmë të gjitha këto prioritetet. Do të diskutoj sa i përket të hyrave komunale dhe parashikimi afatmesëm për vitin 2019-2021, për mua është pak kontrast në tekst i shkruar të hyrat vetanake komunale ndërsa në anën tjetër shkruan rrënjë të hyrave vetanake komunale -29.17%, pastaj më poshtë ceket se kjo rritje kryesisht është koncentruar në të hyrat nga tatimi në pronë. Pra këtu është paraqitur një kontraste sepse duhet të jenë ose të rritura ose të zvogëluara, propozoj që kjo të përmirësohet, sa i përket zvogëlimit të të hyrave e potencoi edhe drejtori që zvogëlimi i ty hyrave vetanake është mos implementimi i tatimit në pronë dhe fillimi i grumbullimit të taksës së mbeturinave, pra kjo ka ndikuar që të hyrat vetanake për vitin 2018 të janë më të vogla se sa në vitin paraprak që kanë qenë. Pastaj këtu është cekur se për tu bërë një taks për grumbullim të mbeturinave duhet të kemi një shumë prej 140,000.00 €, mendimi imë është që kjo shumë duhet të jetë edhe më e madhe por mendoj se kur të vije koha e grumbullimit të mbeturinave do të kemi më shumë detaje. Është për tu theksuar se edhe për vitin 2019,2020,2021 në një farë mënyre nuk është paraparë që do të jepe rritje të të hyrave edhe taksa e grumbullimit të mbeturinave, prandaj mundem të quaj si paafësi e qeverisë komunale që nuk ka arritur ta parashih në KAB realizimin e të hyrave nga taksa për mbeturina. Sa i përket donatorëve të jashtëm këtu ceket se donacionet nga donatorët e jashtëm dhe të brendshëm do të vazhdojnë edhe gjatë viti 2019-2021, bë shumë fusha si në arsim, infrastrukturë etj. Mendoj se është dashur që në KAB të jenë të cekura se cilat janë marrëveshjet aktive për momentin me donatorë të jashtëm dhe me donatorë potencialë për të ardhmen. Pastaj është dashur që ta kemi planifikimin e shpenzimeve sipas drejtorive të paktën për vitin 2019 në kategori ekonomike dhe programe, jemi të vetëdijshëm se ky planifikim mundet të ndryshoj deri në aprovim, por të paktën kishim me pas një orientim se ka do të shkojnë investimet në vitet në vijim. Në fund do të ndalem tek analiza gjinore, janë disa të dhëna po ashtu janë të qartësuara disa çështje se kur të vije puna për investime kapitale, është e cekur se në projekte të ndryshme do të ndahen në baza gjinore meshkuj, femra, nxënës, por sa i përket analizës për buxhetin gjinorë këto shënime që ne i kemi në KAB janë shumë të mangëta dhe nuk i plotësojnë obligimet ligjore.

Florije Boshnjaku – Më vije shumë mirë që Qeveria Komunale së bashku me ne ka arritur që të hyrat vetanake të përcaktuara nga Qeveria e Kosovës të zvogëlohen, është mirë që zë na kuptoj Qeveria e Kosovës sepse Komuna e Rahovecit nuk ka mundësi dhe asnjëherë nuk ka pasur mundësi që të realizoj të hyrat vetanake që i përcaktohen nga ta, sepse ato nuk përputhen me realitetin. Z. Rasim Fazliu e cekur se kanë qenë të paraparë 400,000.00 € të hyra për nga mbeturinat, atëherë kam qenë kundër sepse ne nuk kemi mundësi me i mbledhë këto të hyra vetanake sepse së pari duhet që të ndryshohet statuti, të shtohet edhe një sektor, pastaj të na vije edhe një udhëzim nga ministria përkatëse se si do të zbatohet ky ligj. Nga informatat që i mora nga Drejtori grandit i përgjithshëm i Komunës së Rahovecit për këtë vit është 400,000.00 €, për këtë i përgëzoj dhe më vije shumë mirë sepse kjo shkon në interes të qytetarëve. Sa i përket barazisë gjinore jam duke e pritur buxhetin për vitin 2019, pastaj si prioritet është ngritja e çerdheve të reja në Komunën e Rahovecit dhe mbajtja e mësimit joformal, pastaj do kërkoj që për buxhetin e vitit 2019 në rrugë dhe trotuare të ketë disa pjerrina për gratë që i bartin fëmijët me karroca, mendoj se këtu shihet barazia gjinore. Sa i përket të hyrave që i cekëm për mbeturina mendoj se edhe buxheti për mallra dhe shërbime që është 1,405,000.00 € është e paraparë çështja për mbledhjen e mbeturinave, shpresoj dhe besoj se drejtori i financave dhe i shërbimeve publike do e ngrisin këtë çështje në nivel Kosove dhe një herë e përgjithmonë ta dimë qartë.

Fehmi Cena – Mendoj se KAB-i është një dokument i cili shërben si një udhërrëfyes për kahet e punës së qeverisë, për kahet e zhvillimit dhe për orientimet buxhetore sipas prioritetëve për periudhën e caktuar 3 vjeçare 2019-2021. Mendoj se KAB - është një dokument gjithëpërfshirës, do të mundohem që të japë kontributin tim sa i përkat KAB-it. Në strategji tek vizioni që është i paraparë në KAB janë të paraparë të gjitha dikasteret që janë të rëndësishme përpos shëndetësisë edhe pse është diku e cekur si e posaçme strategjia e shëndetësisë, por mendoj se edhe këtu duhet që të hyjë si preambulë për një shëndetësi më cilësore. Tek forcimi i ekonomisë komunale ceken gjithashtu elementet e rëndësishme si krijimi i zonës ekonomike dhe industriale që është shumë e

rëndësishme për Komunën tonë dhe për këtë mendoj se duhet që të punohet në këtë drejtim. Është punuar diçka por ne nuk kemi zona konkrete me të gjitha kushtet e paraparë për zhvillimin e bizneseve, ne si komunë kemi nevojë. Tek lehtësirat janë cekur: Lirim nga taksat bizneseve prodhuese me theks të veçantë Qeveria Komunale duhet që të jepe rëndësi prodhuesve sepse ne e dimë se çka do të thotë kjo, ata e risim prodhimin vendor, hapin vendet e reja të punës prandaj Komuna duhet që ti mbështet. Sa i përket sektorit të bujqësisë edhe këtu ka vend që të punojë Komuna jonë, janë cekur subvencionet, mendoj se duhet që të ketë me shumë subvencione sepse Komuna jonë është një komunë bujqësore, ceket këtu se shumica e ekonomive familjare vijnë nga bujqësia, po ashtu përmendet sektori i vreshtarisë, këtu duhet që të shtohet edhe sektori i pemëtarisë sepse edhe ky sektor është i rëndësishëm. Pemëtaria po ashtu është një sektor shumë me rëndësi gjithashtu edhe kjo do e risë prodhimin vendor, do të hapë vende të reja të punës, prandaj mendoj se duhet që të ketë edhe ky sektor subvencionim. Pastaj përmendet subvencionimi në mekanizëm bujqësor në perim kulturë, por në vreshtari dhe pemëtarë nuk po e vërej, në strategji për bujqësi është mirë që të shikohet mundësia e çështjes së mbrojtjes së tokës bujqësore për arsye se si Komunë bujqësore që jemi, ne po jemi të vetëdijshëm se toka bujqësore po degradohet me ndërtime çdo ditë dhe Komuna jonë dita ditës po e humbë kuptimin si tokë bujqësore. Rreth infrastrukturës shkollore dhe shëndetësore, është mirë që Komuna të orientohet më tepër në renovime se sa në ndërtime, mendoj se kemi ndërtuar mjaftë objekte, flasë më tepër për shëndetësi por besoj se edhe në arsim gjendja është kështu, ka ambulanca në Komunën tonë që janë ndërtuar por nuk janë funksionalizuar, pra nuk është bërë planifikimi i mirë me kohë, kurse kjo i ka kushtuar me një kosto Komunës ose Qeverisë së Republikës së Kosovës. Mendoj se më mirë kishte me qenë që orientimi të jetë më tepër në ngritjen e cilësisë si në arsim ashtu edhe në shëndetësi. Parandalimi veseve të këqija si droga, duhani, alkooli edhe kjo është shumë e rëndësishme e sidomos drogës duhet që ti jepet një rëndësi e veçantë, kjo është diçka e re për të cilën ne nuk kemi provojë por gjithashtu kjo e keqe është duke ardhur nga ne prandaj ne duhet që të angazhohemi që ta mbrojmë rinin dhe qytetarët tanë. Sa i përket kanalizimeve Komuna jonë ka nevojë të shtrihet si në qytat ashtu edhe në fshatra, por ajo që mua më shqetson si qytetarë është se ne jemi duke i rregulluar ujërat e zeza, por të gjitha jemi duke i derdhur në ujërat sipërfaqësore dhe me këtë jemi duke e degraduar këtë. Prandaj a ka mundësi që ne me e ritë rrjetin e kanalizimit por me e mbrojt ujërat sipërfaqësore. Tek rinia, kultura dhe sporti më pëlqen kjo ide për krijimin e teatrit amatorë i cili është paraparë në strategji, kjo do të ishte shumë pozitive sepse do ta ngris aktivitetin kulturorë, artistik dhe për këtë ka pasur nevojë Komuna jonë. Pastaj intervenimi në monumente kulturore artistike dhe mirëmbajtja e tyre, kemi monumente kulturore artistike që janë afër shkatërrimit, prandaj mendoj se për këtë ka nevojë një intervenim emergjent, nëse ka mundësi buxhetore kishte me qenë mirë që të intervenohet sa ma shpejtë sepse edhe ndonjë ditë disa monumente do të zhduken plotësisht. Tek parashikimi i buxhetit është paraparë që nga viti 2019 e tutje të zvogëlohen të hyrat buxhetore edhe pse për mua është pakës paradoks sepse nëse nga viti 2019 do të aplikohet tarifa e pagesës së tatimit në tokë e cila nuk është tani, kjo taksë do të ketë të hyra, pastaj edhe nga pagesat e mbeturinave edhe këtu do të ketë të hyra, prandaj pse duhet të ketë zvogëlim në të hyrat vetanake. Të hyrat në shëndetësi që janë planifikuar, të hyrat vetanake 50,000.00 €, sugjerimi imë për Drejtorin e Shëndetësisë është që të punojë pak më shumë në sistemin e informimit të shëndetësisë e kam përmendur edhe më parë sepse sapo kemi filluar është ndërprerë dhe nuk është vazhduar më, kurse është një projekt i cili ka rëndësi në të hyrat vetanake. Dhe në fundë prapë do diskutoj rreth subvencionet, është vlere e cekur 196,000.00 €, që në përqindje i bie 1.76 %, mendoj se kjo është një vlerë shumë e vogël sa i përket subvencioneve në bujqësi duke marrë parasysh që Komuna jonë është bujqësore dhe ka nevojë më tepër në mënyrë të dele në ndihmë fermerëve dhe pastaj ajo të i kthehet pozitivisht Komunës.

Mirjeta Krasniqi – E shfletova materialin por aty ku unë dua të ndalem është arsimi pasi i përkas kësaj fushe, nëse vërtet këto pika siç janë të renditura do të mirën për bazë atëherë është shumë me rëndësi sepse këto janë problematikat kryesore që ne i hasim çdo ditë në punën tonë. Është filluar të punohet me korikulën e re por kushtet infrastrukture nuk korrespondojnë fare në të gjitha shkollat në përgjithësi gjendja është e njëjtë, uroj që kjo gjendje të përmirësohet me ato kabinete që i keni paraparë. Tek pika e cekur bashkëpunimit, është shumë e nevojshme që të kemi bashkëpunim me këshillat drejtues si të nxënësve ashtu edhe të prindërve, mendoj se ju si ekzekutiv duhet që të keni bashkëpunim me këto këshilla sepse ne nuk mundemi që të kemi sukses pa

bashkëpunim me këto këshilla sepse mosbashkëpunimi me ta më së shumti pësojnë nxënësit. Pastaj sa i përket donatorëve e përmendi i nderuari z. Rasim Fazliu se sa projekt janë paraparë, po ashtu edhe unë dua ta di se sa projekte janë paraparë me donatorë, sa projekte janë të lidhura me donatorë dhe cilat janë ato projekte. Ne e dimë se buxheti jonë është i kufizuar prandaj pa ndihmën e donatorëve ne nuk mundemi të arrijmë të ndërtojmë ose meremetojmë shkollat në përgjithësi.

Florida Bajraktari – Desha të ndalem tek sektori i bujqësisë, kur thuhet fuqizimi i qendrave grumbulluese të qumështit, a i bie që do të i ndihmohet fermerëve që të i mirëmbajnë ato qendra, apo do i ndahen mjete materiale për ndërtimin e qendrave të tjera grumbulluese të qumështit. Pastaj sa i përket ndërtimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve fushore dhe ndërtimi i kanalit të kullimit në zonat ku paraqiten vërshimet, kishte me qenë mirë që të ndërtohen sa ma shpejtë të intervenohet në ato vende ku është shumë e nevojshme.

Besë Bytyqi – Do të ndalem tek pika 3.4 tek analiza gjinore, nëse e bëjmë një analizë të drejtorive të numrit të punësuarve të femrave dhe meshkujve, do të shohim se 8 drejtori nuk e kanë asnjë femër të punësuar, drejtorja e arsimit dhe shëndetësisë që janë nga drejtoritë më të rëndësishme nuk e kanë asnjë femër të punësuar. Do të bëja thirrje që të privilegjohej pak ma shumë femrat, të punësohen pak më shumë gjithmonë e them në kushte të barabarta me meshkuj, por nëse janë të punësuar në një institucion 37 femra dhe 186 meshkuj është me të vërtetë një disbalancë e madhe.

Ali Morina – Kolegët parafolës i shtjelluan ku dhanë sugjerimet dhe vërejtjet e tyre për secilën fushë, mua nuk më mbeti pothuajse asgjë për të diskutuar, por ajo që desha unë të kyçem është krijimi i zonave ekonomike, e dimë që tash së fundi Qeveria e Republikës së Kosovës së fundi ka marrë një vendim për themelimin e zonës ekonomike në Rahovec, ky është një lajmë për tu përshëndetur dhe sigurisht se kjo do të ndikojë pozitivisht në politikat e të bërit biznes në Komunën e Rahovecit. Pastaj tek Drejtorja për Kulturë, rini dhe sport ajo që më bërë përshtypje është krijimi dhe funksionalizimi i kuvendit të rinjve, tani më është bërë hapi i parë dhe kuvendi i të rinjve është themeluar, e përgëzoj Drejtorin z. Ervin Hoxha për një gatishmëri për të ju dalë në ndihmë dhe për të i mbështetur rininë me projekte dhe ide të tyre. Ne i japim mbështetje të plotë KAB-it dhe jemi pro këtij vendimi.

Ali Zhuniqi – Meqë jemi duke diskutuar KAB-in ku u thanë shumica e gjërave esenciale nga kolegët parafolës, jemi duke diskutuar KAB-in dhe disa projekt propozime në lidhje me fshatrat që vuajnë më së shumti si fshati Fortes, Celinë, Xërxë, kam diskutuar edhe në mbledhjen emergjente që e kemi pasur prandaj është shumë mirë që të përcaktohet buxheti për rregullimin e shtratit të lumit në Fortesë sepse ky është problemi kyç i cili është duke shkaktuar dëme të konsiderueshme edhe në bujqësi dhe amvisëri. Po ashtu është mirë që të rregullohet edhe rrjeti i kanalizimit i cili është duke shkaktuar dëme si në Fortesë ashtu edhe në Xërxë. Pastaj problemi esencialë për fshatin Fortesë është po ashtu ndërtimi i shkollës fillore sepse me të vërtetë shkolla ekzistuese është në një gjendje të mjerueshme, ne e kemi diskutuar edhe më herët këtë problem, ku Kryetari patë cekur se nëse gjendet ndonjë donator i jashtëm prioritet do të jetë ndërtimi i shkollës fillore në Fortesë, por Kryetari nuk ka dhënë premtim konkret që së paku në bazë të vijave buxhetore nga të hyrat vetanake të vitit 2019 të ndërtohet shkolla. shumica e shkollave në Komunën e Rahovecit janë të ndërtuara, por nuk e di pse është lënë anash shkolla në Fortesë edhe pse partitë që janë në pushtet mbështeten mjaftë në ky fshat. Mendimi imë është që e gjitha kjo është për shkak të mos punës së kuvendarëve dhe drejtorëve që kanë qenë nga ky fshat, prandaj kisha sugjeruar drejtorin z. Rumir Zhuniqin, Kuvendarin z. Masar Popaj që të ngritin zarin dhe të mirën konkretisht me këtë sepse kjo shkollë është me të vërtetë në gjendje të mjerueshme. Por ajo që jam duke parë është se që nuk ka ndonjë reflektim nga ana e Kryetarit të Komunës që të mirët me problemet që e shqetësojnë fshatin Fortesë, si rregullimi i shtratit të lumit, rregullimi i kanalizimit dhe ndërtimi i shkollës, ju siç e dini kur ka vërshime paraqiten probleme të mëdha, nuk është marrë asnjë masë që nga koha e z. Idriz Vehapi e deri më tani, problemet janë të mëdha dhe kjo është turp për ne, kurse dalin këtu dhe na mbajnë filozofi, të nderuar duhet që të mëreni me sende konkrete të cilët janë të prekshme për qytetarë. Pastaj problemi tjetër në fshatin Fortesë janë trotualet dhe hapësirat gjelbëruese edhe pse këto hapësira në të shumtën e rasteve mirëmbahen nga qytetarët, por kujdes nga Komuna nuk kanë, mendoj se qeveria aktuale këto problematika që i ceka duhet që ti ketë si prioritate.

Sali Sallteku - Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, nuk do e zgjasë shumë, KAB-i është paraqitur ashtu siç është gjendja edhe pse ka disa gabime të vogla, po ashtu mendoj se drejtorët e drejtorive nuk ja kanë dërguar

shënimet bashe mirë, pe marr shembull DKA-ja e ka edhe një femër të punësuar këtu nuk është cekur etj. konsideroj se edhe ajo që e thatë ju dhe nënkryetari për vizitën e Ministrit të Bujqësisë, është mirë që ti bëhet sa më shumë presion sepse me të vërtetë bujqit e Komunës së Rahovecit kanë pësuar shumë dëme, të vije gjynah të dalësh dhe të shikosh se çfarë dëme janë bërë, i mjerë ai që është i varur vetëm nga ky sektor prandaj duhet të jemi më vigjilent dhe të mundohemi që ti dalim në ndihmë sadopak bujqve të Komunës sonë.

Afrim Limani – Të nderuar kuvendarë ju faleminderit për pyetjet që i keni parashtruar, do të mundohem aq sa kam mundur që ti shënojë që të ju japë përgjigje. E nderuara znj. Fahrije Lushi Morina të ju them sinqerisht se infrastruktura në arsim është në top prioritetet tona, me theks të veçantë ndërtimi i shkollave, çerdheve, riparimi i objekteve dhe të gjitha projektet e tjera që janë të rëndësishme së veçantë në arsim. I nderuar z. Rasim Fazliu i kam parasysh sugjerimet e tua, pastaj sa i përket donacioneve Komuna e Rahovecit vazhdimisht ka pasur donacione të cilat kanë rrjedhur dhe do të rrjedhin, aktualisht unë i kam shënimet dhe i kam të dhënat për disa projekte të cilat janë në proces dhe që munden të vazhdojnë, por më gjerësisht në mbledhjen e radhës do të sjelli një raport për ty dhe znj. Mirjeta Krasniqin. E potencuat për pjesën e zbrazët të buxhetit, konkretisht ne aty jemi orientuar tek shpërndarja e buxhetit sipas kategorive ekonomike në programe, e thash në fillim se këtë do e lëmë në qarkoren e dytë buxhetore ku aty saktësisht do të përcaktohen limitet dhe pastaj do të plotësohet ky tabelar. Znj. Florije Boshnjaku të falënderoj që më lavdërove, po ashtu do i mare parasysh sugjerimet e tua. Sa i përket barazisë gjinore kjo pyetje shkon edhe për z. Sali Sallteku dhe znj. Besmire Bytyqi, ne në KAB e kemi paraqitur strukturën gjinore sa meshkuj dhe sa femra ka në tre sektorë si Administratë, shëndetësi dhe arsim, më poshtë në atë listë i keni të gjitha shënimet, në qarkoren e dytë buxhetore ne do të dalim me shënime se sa është pjesëmarrja e gjinisë femërore në të gjitha sektorë dhe në buxhet total të Komunës sipas kategorive. I nderuari z. Fehmi Cena do i kem po ashtu parasysh sugjerimet juaja, e kam bërë përmirësimin që e keni cekur, tani është edhe pemetaria, ndërsa sa i përket subvencioneve Ministria e Financave na e qetë një limit ose tavan dhe ne nuk guxojmë që të shkojmë më tepër, pra kjo është arsyeja pse nuk mundemi që ti shtojmë subvencionet. Do ti adresohem me kërkesë Ministrisë së Financave ku do e cekim se janë shumë të pakta subvencionet sepse këto subvencione e mbulojnë sektorin e shëndetësisë, kulturës, bujqësisë dhe shumë sektorë të tjera. Aktualisht në Republikën e Kosovës është ligji mbi financat publike dhe përgjegjësi dhe realisht ne veprojmë në bazë të ligjeve dhe nuk guxojmë të dalim nga ligji, por për të ardhmen do të shohim sepse ka kërkesa që ky ligj të ndryshojë dhe pastaj do e shohim se çka mundemi të bëjmë. Sa i përket tatimit në tokë, kjo për ne është sfidë në vete, është përvojë e parë dhe të ju them të drejtën nuk jemi të sigurtë se sa do të jenë të hyrat nga tatimi i tokave, paraprakisht ne jemi të përgatitur e kemi një softuerë me shënime që na ka dërguar Ministria e Financave dhe që nga viti 2019 do të fillojë inkasimi në toka. E nderuara znj. Mirjeta Krasniqi sa i përket donacioneve do ta kesh në mbledhjen e ardhshme një raport. E nderuara znj. Florida Bajraktari këtu kemi të bëjmë me subvencionim të qendrave qumështore me pajisje të ndryshme përkatëse. Z. Ali Zhuniqi do i marr parasysh sugjerimet tua dhe shqetësimi juaj është me plotë arsye, por shpresoj se me përpilim të buxhetit do të jepni edhe ju kontribut, por sa për informim në kuadër të listës së projekteve kapitale në kuadër të bujqësisë ekzistojnë tre projekte të cilat janë për kullim të tokave bujqësore.

Kryesuesi – E qes në votim Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Rahovecit 2019 – 2021: Konstatohet se me 3 abstenime dhe të tjerët pro është aprovuar pika e tretë (3) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

4. Shqyrtimi i Planit të Veprimit Komunal Kundër Korrupsionit.

Nënkryetari – Është fjala për Planin të Veprimit Komunal Kundër Korrupsionit për vitet 2018-2021 jemi bazuar në atë që jemi ende në muajin qershor, por sidoqoftë si ta shihni ju të arsyeshme ne mund ta qesim edhe si Plan të Veprimit Komunal Kundër Korrupsionit 2019-2021, ne këtë Planin të Veprimit Komunal Kundër Korrupsionit është dashtë ta bëjmë si Komunë, besoj se e kanë edhe Komunitetë tjera është ekskluzivisht rekomandim i auditorit të jashtëm por edhe rekomandim i MAPL-së, në këtë plan janë paraparë objektivat dhe strategjitë si dhe masat të cilat duhet të ndërmerren për zbatimin e këtij plani, janë paraparë edhe sektorë dhe fusha ku duhet të ndërmerren masa për zbatimin e këtij plani, unë diçka tjetër nuk kam të shtoj rreth prezantimit të këtij plani mirëpo kërkoj prej juve që të jepni kontributin tuaj në mënyrë që ta pasurojmë edhe më tutje këtë plan edhe kur të votohet edhe me

rekomandimet e juaja, propozimet e juaja të inkorporohen në këtë plan edhe pastaj na mbetet neve si Qeveri Komunale bashkë me juve ta zbatojmë planin 3 vjeçar pastaj prej vitit 2021 të shikojmë çka mund të bëhet, të plotësohet, ndryshohet etj. Ju faleminderit shumë.

Mirjeta Krasniqi- Faleminderit z.Kryesues, ky plan duket si shabllon që është marrë nga Komunat tjera duhet ta kemi këtë plan mirëpo sa do të zbatohet është pikëpyetje, uroj të mos mbetet letër në sirtar është shumë me rëndësi të ketë një kanal të besuar për raportimin e shkeljeve kundër korrupsionit pasi që besimi po humb nëse duhet apo jo të raportohet një shkelje, shkelje të ndryshme të çfarëdo natyre që po ndodhin në përgjithësi, unë shumë e përkrah këtë plan kundër korrupsionit, uroj edhe njëherë po e them që të gjejë zbatim edhe pse është hera e parë që na vjen siç e ceku edhe nënkryetari mirëpo veç dua zbatimin e mirëfilltë siç e keni paraparë vet shumë bukur po duket në letër, faleminderit.

Florije Boshnjaku- Në lidhje me këtë Plan të Veprimit Komunal Kundër Korrupsionit për vitet 2018-2021, kam një pyetje për nënkryetarin, zyrtarin ligjor apo dikush kush ka informata a ka strategji në nivel vendi apo nivel kombëtar kundër korrupsionit edhe nëse ka strategji në bazë të asaj strategjie niveli qendror, a ka qenë më mirë ta kemi edhe ne një strategji kundër korrupsionit e në bazë të strategjisë ta përpilojmë edhe planin e veprimit, ky plan ka qenë edhe më herët i nevojshëm, është i nevojshëm, faleminderit ju përgëzoj për punën, shpresoj që të gjejë zbatim dhe të punojmë të gjithë së bashku për realizimin e këtij plani.

Qazim Qeska- Unë jam i vetëdijshëm shumë që lufta kundër korrupsionit është obligim kushtetues, obligim ligjor edhe statut ar i administratës komunale në përgjithësi duke përfshirë prej menaxherit deri tek ne këtu që jemi si këshilltarë, por nënkryetari e tha mirë që mund të japim kontribut por unë konsideroj që paraprakisht ka qenë ndoshta më e justifikueshme që në punimin e këtij drafti të përfshihen edhe përfaqësuesit e Kuvendit në veçanti komisionet, trupat e përhershme e Komunës së Rahovecit me qëllim që ky plan i veprimit për periudhën 2018-2021 të jetë më gjithëpërfshirës, e para një pyetje paraprake mandej do të vazhdoj, zoti Kryesues a e kanë paraparë planifikuesit apo sponzoruesit e kësaj pike që këtë draft ta dërgojnë edhe në debat publik apo jo? Këtu në plan e tha edhe një kolege jona është shabllon por unë nuk do të them ashtu, i kanë paraparë objektivat dhe qëllimet mirëpo masat vetëm i kanë përmendur kështu shkarazi ngase i gjithë qëllimi konkret apo përfundimtar i planit të veprimit kundër korrupsionit është që të parashihen masat konkrete duke filluar prej Kuvendit deri tek nëpunësi më i thjeshtë i administratës komunale ngase korrupsioni siç e kemi cekur këtu i përfshin të gjitha porët e jetës dhe të punës në administratën komunale por pse jo edhe në shoqëri përgjithësi, kështu që në qoftë se ky plan i veprimit aprovet si draft edhe ka orientim që të dërgohet në debat publik unë konsideroj që ai do të pasurohet edhe do të jetë më efektiv e në fund edhe më efikas për neve të gjithëve, ju faleminderit.

Fahrije Lushi- Morina- I nderuar Kryesues, meqë e tha edhe nënkryetari edhe unë pajtohem që ta marrim tani për tani si plan i cili më tepër përmban strategji që duhet ndjekur dhe le të mbetet si alternativë e re më mirë të themi ashtu sepse i ka përmasat e kapshme për të gjithë ne si kuvendarë por që duhet të jetë më gjithëpërfshirës sepse detajet brenda këtij plani më tepër tingëllojnë si hapa nëpër të cilët duhet të kalojë tani për tani ky plan, ju faleminderit.

Fehmi Cena- Faleminderit z.Kryesues edhe unë pajtohem me mendimin e parafolësve e para punës që ne e kemi një Plan të Veprimit Komunal Kundër Korrupsionit që Komuna për herë të parë po del me një shkrim të tillë, mendoj se sa i përket korrupsionit është një dukuri negative u cek edhe nga parafolësit që është një sëmundje, është një dukuri që e ka përfshirë me të vërtetë shoqërinë tonë po përflitet shumë si në nivel të institucioneve lokale ashtu edhe qendrore, u tha se është edhe detyrim ligjor edhe detyrim kushtetues unë kisha me thanë edhe ndërkombëtar se ne si vend si Kosovë e dimë që kemi edhe detyrime, si kusht për integritetin në procesin e Bashkimit Evropian, pikërisht kjo çështja e korrupsionit dhe krimit të organizuar sepse këto shkojnë bashkë, në aspektin e gjuhës mjekësore unë kisha me thënë se korrupsioni është kancer për zhvillimin e shoqërisë, sikurse kanceri që e pengon zhvillimin e shëndetit e dëmton dhe në fund e shkatërron organizmin edhe korrupsioni është e keqe e madhe që e dëmton shoqërinë e pengon zhvillimin e saj ekonomik edhe në çdo aspekt edhe në fund e shkatërron sigurisht edhe perspektivën e vendit prandaj mendoj që në këtë drejtim ky plan është për tu përkrahur por duhet të jetë gjithëpërfshirës pajtohem me parafolësit që thanë se duhet të kyçen edhe struktura të tjera edhe trupa tjerë të Kuvendit Komunal që të japin kontributin e vet këtu dhe të jetë më i kompletuar, elementi që duhet

të merret parasysh në plan të veprimit për korrupsion është gjithmonë transparenca në çdo veprim duhet të kemi parasysh transparencën, mua më vrau syrin një shkresë këtu që thuhet tek po e zëmë menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore dhe një si rekomandim që të merret ndonjë bashkëpunëtor profesional nga jashtë etj do të thotë ne të gjithë i kemi mendimet tona po e zëmë unë do të kisha menduar që më mirë do të ishte një profesionist dikush që ne e kemi nga Komuna jonë që e njohim mirë, një njeri profesional të përgjegjshëm, ndërgjegjshëm që të merr pjesë në këto komisione për të ju shmangur korrupsionit sesa dikë nga ndonjë Komunë tjetër ose një kompani p.sh që është bërë praktikë po merret kompania prej një Komune tjetër gjoja se me i ikë korrupsionit se këtu njihemi e në fakt ajo mund ta luajë një rol të kundërt për tu zbatuar plani i luftës anti-korrupsion atëherë duhet më tepër sigurisht vullnet më tepër i pushtetarëve i atyre që mendojmë ne se i nënshtrohen më tepër kësaj dukurie negative korrupsionit, prej hallkës më të lartë sigurisht menaxhmentit, korrupsioni mundet të jetë edhe në hallkat më të ulëta siç është edhe administrata e kështu me radhë, ju faleminderit.

Ali Morina- Unë desha të ndalem pak tek një kategori apo një sektor ku më së shumti mund të atakohet nga kjo dukuri që është prokurimi publik ndoshta për të i evituar mundësitë e keqpërdorimeve në këtë sektor do të ishte futja në funksion e prokurimit do të thotë paraqitja online e të gjitha ofertave për tenderë besoj që do të ndikonte pozitivisht jam i informuar pak a shumë që është filluar me një projekt të tillë edhe tek kadastra janë disa afate ligjore aty tek bartja e pronësisë apo për një vendim për bartje të pronësisë merr kohë deri në tre ditë besoj që është një afat i gjatë që i shtyn nëse dikujt i duhet një vendim pak më shpejtë i shtytë për të gjetur rrugë për ta përshpejtuar këtë procedurë ndoshta nuk e di sa do të kishte mundur të ndikonte në zvogëlimin e këtij afati ligjor, por do të ndikonte pozitivisht dhe do të parandalonte mundësinë e korrupsionit të zyrtarëve në këtë drejtim, ju faleminderit.

Ali Zhuniqi- Korrupsioni tashmë është një dukuri e cila ka hyrë në celulë të çdo institucioni shtetëror d.m.th është një problem madhor unë i pashë objektivat edhe masat të cilat duhet të gjejmë zbatim, por shumicën e gjërave i cekën kolegët e mi të nderuar, znj.Boshnjaku tha që e kanë humbur besimin qytetarët znj.Boshnjaku për ty është mandati i tretë është dashur të punosh në këtë drejtim për me të besu qytetarët edhe me ju kthye besimin ju jeni ata që ju keni humbur besimin qytetarëve, z.Qeska tha prapë e kemi për obligim ai e ka pasur një mandat pse nuk është mundur së paku ta zvogëlojë qashtu njëjtë z.Fehmi Cena tha ka në Evropë korrupsion, nuk d.m.th që ka në Evropë korrupsion të ketë edhe këtu tash është një çështje jashtëzakonisht e ndjeshme, dua të ndalem tek pika e 7 ku fillojnë objektivat strategjike ku shumë mirë thotë është veçanërisht e rëndësishme që menaxhimi i lartë të ndërmarrë hapat konkret për të koordinuar politike bërjen e ofrimit të shërbimit të pushtetit lokal për ti eliminuar situatat të cilat politikat e ndryshme të cilat krijojnë qasje jo të drejtë tek qytetarët për shërbime, është një problem jashtëzakonisht kur niset direkt prej Kryetarit edhe vazhdon tek prokurimet publike, këtu bëhen dallaveret e mëdha, këtu nuk ka transparencë aty tek tenderët ku i jepen projektet dhe investimet kapitale të cilët orientohen nëpër fshatra, mos ta lëmë Qeverinë ajo më është e zhytur dihet domethënë aferat e klanit pronto, punësimet në baza familjare, nepotizëm e krejt e njëjta praktikë vazhdon edhe këtu, është mirë shumë nëse këto objektiva gjejmë zbatim por unë sinjerisht po ju them nuk ju besoj.

Nënkryetari- Faleminderit shumë për kontributin tuaj, Mirjeta e përmendi është copy paste ka disa pjesë ne nuk kemi mundur ta fillojmë prej shkronjës së parë e deri tek e fundit është e pranueshme kjo, absolutisht edhe nëse ja nisim të formojmë komision jeni të bindur që asgjë nuk do të bëjnë jashtë kësaj për arsye se duhet me e njohtë një fushë për ta bërë këtë punë edhe nëse nisemi nga ajo të jeni të bindur që asnjë anëtar i komisionit nuk do të japë kontribut më tepër nëse përpilohet ky plan ose shtohet përpos asaj që me marr diku në internet edhe ta shtojnë këtë plan pajtohem ashtu mund ta bëjmë mirëpo nuk ka nevojë, një sqarim strategjia kundër korrupsionit ka një strategji kundër korrupsionit në kuadër të zyrës së Kryeministrit që është bërë me 15 janar nëse nuk gaboj edhe është një strategji që kap vitet 2018-2021 ndërsa në bazë të asaj strategjie Komunitat lidhen edhe bëjnë plane do të thotë krejt kjo strategji është bërë në kuadër të zyrës për qeverisje të mirë d.m.th përfshihen këta aktorë tjerë ne nuk kemi nevojë këtu të bëjmë strategji e kemi një strategji Komunitat bazohen në atë strategji edhe e përpilojnë këtë plan është hera e parë që Komuna e Rahovecit e ka një plan tash a është i mirë ky plan edhe unë them ndoshta jo ka ndonjë mungesë mirëpo është më mirë me pas një plan kundër korrupsionit sesa mos me pas hiç, kur lidhemi edhe me rekomandimet e Ministrisë përkatëse por edhe të auditorit të jashtëm i cili kërkon

vazhdimisht me e pas këtë plan ku do të i kemi edhe planet e tjera që kemi për të i diskutuar këtu në seancat e ardhshme, tani a i besoni këtij plani? Ne nuk jemi të thirrur këtu të i besojmë njëri-tjetrit absolutisht as ti mua as unë ty mirëpo kur jemi institucionalist atëherë duhet ta zbatojmë këtë plan sa zbatohet ajo tash po të tregoj Ali ty edhe të tjerëve aq sa di, duhet ta dallojmë konceptin e administratës me organet tjera, ne jemi administratë adresohen çështje përmendet aty edhe ankesa, përmendet aty edhe një person përgjegjës që do të i trajtojë këto ankesa edhe është kjo Agjencia Kundër Korrupsionit të gjitha ato barten tek organet tjera, kemi edhe policinë edhe gjykatën edhe prokurorinë krejt këto gjëra pastaj trajtohen diku tjetër tash a i besoni apo jo prapë është çështje tjetër, ne jemi këtu institucionalist edhe duhet ta punojmë një plan që ta ketë Komuna sa do të gjejë zbatim do ja lëmë kohës kur të hyjë në funksion ky plan a do ta lëmë në 2018 korrik 2021 a do ta lëmë 2019-2021 është prapë çështje tjetër, mirëpo nuk ka nevojë as të debatohet është vetëm plan nuk është rregullore që ka nevojë të del në debat publik është një prioritet që e ka përcaktuar Qeverisja Komunale, thirrje nga qytetarët unë jam në komunikim me zyrtarët e valës do të ketë një linjë 08000 ose 0800 sa do të jetë ai numër ku qytetarët do të lajmërohen jo vetëm për këtë çështje por edhe për çështje tjera linja do të jetë e hapur 24/7 edhe tek prokurimi elektronik përkatësisht është bërë ky e-prokurimi ose prokurimi elektronik për ta ngritur transparencën, sa është ajo transparencë është dikush tjetër që merret prapë me ato punë, për çështje të tjera nuk dua të hy në ato gjëra të tjera të Qeverisë, sa punon ajo prapë janë qytetarët të cilët kanë për ta vlerësuar në vota edhe unë kërkoj prej juve që ta miratoni këtë plan kundër korrupsionit edhe ne jemi ata që bashkërisht duhet ta zbatojmë, janë qytetarët ata që njëherë neve duhet të na drejtohen e ne organeve kompetente që ekskluzivisht merren me këto çështje janë policia, prokuroria janë organet e Gjykatës kështu që kërkoj prej jush ta mbështetni këtë plan të veprimit kundër korrupsionit me ato propozime që i keni nëse ka diçka me u inkorporua e nëse jo atëherë të vazhdojmë kështu nuk do të thotë që ky plan do të jetë kështu nëse ka nevojë të plotësohet, ndryshim plotësimin dhe plotësim ndryshimin mund ta bëjmë prapë edhe në vitin e ardhshëm kështu që mbetet tek ju ta përkrahni dhe të vazhdojmë tutje, në mënyrë që ta kemi një plan se sa mos të kemi hiç, faleminderit shumë.

Kryesuesi- E qesim në votim pikën e 4 Shqyrtimi i Planit të Veprimit Komunal Kundër Korrupsionit, konstatoj se në mënyrë unanime aprovohet pika e 4 e rendit të ditës, kalojmë në pikën e 5 të rendit të ditës.

5. Shqyrtimi i Raportit të Performancës Komunale.

Nënkryetari - Faleminderit, pasi që kemi disa punëtorë në pushime vjetore e mora përsipër ta prezantoj aq sa di në fushat që ata merren tërë kohën ndërsa mua më bie pak më rrallë, është raporti i performancës është edhe një vendim i cili Kryetari i Komunës e ka formuar në krye të grupit punues për performancë komunale është Bjondina Rama – Fazliu meqë është në pushim vjetor e ceka unë e mora përsipër me e prezantu para juve, është obligim ky raport ose informatë ta quajmë që çdo vit të i sillet Kuvendit me e pa dhe ta diskutojmë meqenëse këtu nuk mundemi diçka të shtojmë për arsye se është raport i cili është dërguar në MAPL por vetëm diskutohet sa i takon transparencës, zakonisht të dhënat mblidhen diku në fillim të Janarit diku deri më 15 Shkurt zgjat ajo procedura mblidhen të dhëna në çdo fushë edhe data 31 Maj është data kur dorëzohen të gjitha këto të dhëna që përmbledhen, dorëzohen në MAPL edhe në atë raport siç mund ta shihni edhe ju ka 14 fusha që raportohet dhe 65 tregues, në atë raport po ashtu paraqiten arritjet pak më të larta që janë arritje të mesme edhe ato arritjet që quhen më të ulëta ose gati hiç arritje, kështu që kjo është ajo unë besoj që këtë raport të performancës ju e keni diskutuar edhe qëllimi është që ne me e ngrit transparencën dhe performancën edhe njëkohësisht dua ta falënderoj edhe Qeverinë e kaluar ku në bazë të punës që ka bërë edhe ajo transparencës, performancës sa i takon Komuna e Rahovecit ka fituar një grand prej Demosit në vlerë prej 95,000€ edhe ky buxhet pastaj shpërndahet aty ku ka nevojë më tepër, nëse nuk gaboju një pjesë e këtyre mjeteve do të shkojnë në fshatin Xërxe sa i takon ndriçimit publik apo edhe disa projekte kapitale që mund të bëhen, kështu që qëllimi ynë është me e ngrit transparencën, me rrit efikasitetin në punët tona që i kemi në mënyrë që të fitojmë grande edhe më tutje dhe këto grande ose mjete në vlera buxhetore të shpërndahen aty ku ka nevojë më tepër, faleminderit shumë, këtu i kam me vete një grumbull të letrave në bazë të fushave që janë plotësuar janë dy formate elektronik dhe Excel por në pamundësi të printimit për të gjithë si dokument fizik i mora me vete ashtu si mi ka dhënë Bjondina vetëm për të ju treguar se është mjaft i madh edhe besoj që ndoshta nuk ka pasur nevojë të ju ngarkojmë me këtë, por vetëm si një informatë rreth

performancës komunale me qëllim që të vazhdohet tutje edhe të fitojmë grande sa më shumë edhe ky është qëllimi ynë.

Rasim Fazliu- Falënderoj Nënkryetarin për informatën që na dha rreth raportimit të performancës komunale, nuk kemi shumë çka të shtojmë rreth kësaj mirëpo desha të them që është mirë që edhe Qeverisja Komunale edhe ne si anëtarë të Kuvendit edhe si qytetarë, Komuna e Rahovecit të shkojë mirë le të rritet aktiviteti në mënyrë që edhe në të ardhmen të kemi një performacë të mirë dhe të marrim kështu donacione sikurse e kemi marrë prej Demosit, d.m.th edhe në këto fusha ku arrijtjet janë më të ulëta për tregues është mirë të tentohet të rritet performanca, të dalë një performancë më e mirë, edhe për ne është mirë por edhe për arrijtjen e qëllimeve të caktuara ekonomike e të tjera, ju faleminderit.

Florije Boshnjaku- Faleminderit Kryesues, faleminderit Nënkryetar lidhur me këtë informatë për performancën e Komunës, falënderoj edhe ish Qeverinë Komunale që ka arritur gjithmonë në interes të qytetarit, mirëpo propozoj që arrijtjet ku i kemi treguesit më të ulët, p.sh tek barazia gjinore, tek gjelbërimet publike, personat me aftësi të kufizuara tek parkingjet të merret parasysh dhe të merren masa që këtu të rritet kjo performancë dhe dashtë Zoti që në të ardhmen të përfitohen sa më shumë grande mirëpo gjithmonë duke e pas parasysh dhe duke i dhënë prioritet edhe fushave ku kemi performancë më të ulët, ju faleminderit.

Fehmi Cena- Mendoj se me këtë raport është bërë një punë e mirë së paku që ne po informohemi me shkallën e performancës në Komunën tonë në lidhje me këto fusha që po raportohet, ku ceket këtu 14 fusha dhe 65 tregues, kam një vërejtje të vogël rreth punës teknike në përpilimin e këtij raporti në faqen e parë nga ajo punëtorja, se është dashtë me i minimizu fushat 1-14 kjo është dashur të bëhet një radhitje më të saktë në mënyrë që raporti kur përpilohet gjithmonë duhet të jetë sa më i qasshëm të ketë një qasje sa më të lehtë sepse kjo nuk është për vetëm ne këshilltarët por është edhe për ne qytetarët që të kemi një qasje sa më të lehtë rreth këtyre gjërave, në tabelën e dhënë me përqindje të gjitha këto fushat e performancës bien në sy u cek nga parafolësit sipërfaqe e hapësirave të gjelbëruara publike që janë të vogla ne e dimë d.m.th neve na mungojnë shumë parqe, shëtitore, trotuare, qytetarët tanë nuk kanë ku të shëtisin, ka nevojë që të punohet në këtë drejtim si në qytet si në fshat çdo vendbanim çdo lagje çdo fshat ka nevojë sot të ketë edhe shëtitore se dalin qytetarët shëtisin nëpër rrugë thithin pluhurin edhe janë të rrezikuar nga automjetet prandaj këtu duhet ta ketë parasysh Qeveria lokale të investojë në këtë drejtim, tash është bërë modë doktorët porosisin që qytetarët duhet me dal me ec , me vrapu ajo është e mirë për shëndet mirëpo nëse nuk ka ku atëherë është një henidkep, prandaj është një kërkesë që çdo vendbanim të ketë më tepër gjelbërim, shëtitore dhe parqe, faleminderit.

6. Shqyrtimi i propozim Vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm pjesën e parcelës P-71513005-00524-4, në fshatin Krushë e Madhe.

Afrim Oruçi- Përsëndetje për të gjithë, Drejtoria për Gjeodozi Kadastër dhe Pronë ka pranuar një kërkesë nga OVL-ja ku ka kërkuar prej nesh në bashkëpunim me zyrën e Kryetarit me inçizu gjendjen faktike në Krushë të Madhe ku sot janë vend rëniet e dëshmorëve të Kombit, Bekim Gashi dhe Dalip Behra, bëhet fjalë për zonën kadastrale në Krushë të Madhe në sipërfaqen prej 153m² është zonë komunale e Rahovecit, arsyetimi qëllimi i vetëm është mirëmbajtja rregullimi dhe ruajtja e këtyre vendeve , ftoj kuvendarët pas diskutimit ta votojnë dhe ta përkrahin propozim vendimin e Kryetarit, ju faleminderit.

Rasim Fazliu- Është mirë që është bërë një kërkesë prej OVL-së që të shpallen këto zona të interesit të përgjithshëm publik se falë këtyre njerëzve që dhanë jetën për lirinë e Kosovës ne sot jetojmë të lirë, kështu që e përsëndesim këtë aktivitet gjithsesi mirëpo unë e kam një vërejtje, kërkesa e OVL-së dhe vendimi nuk po përputhen po e cek p.sh se kërkesa është shkruar që kërkojmë nga institucionet e lartpërmendura që të fillojnë procedurat me incizimin dhe identifikimin e pronave në vend rënie të dëshmorëve ku janë ngritur lapidarët, pra po e potencoj ku janë ngritur lapidarët, ndërsa në vendim pika dy thotë qëllimi për shpalljen e interesit të përgjithshëm pjesën e parcelës P-71513005-00524-4, në fshatin Krushë e Madhe i këtij propozimi është ngritja e lapidarit të dëshmorëve të kombit në fshatin Krushë e Madhe, d.m.th është mirë të harmonizohet përndryshe edhe këtë pikë edhe tjetrën me radhë që vjen e mbështesim plotësisht por vetëm desha këtë çështje ta sqaroj, ju faleminderit shumë.

Kryesuesi – E qesim në votim pikën e 6 të rendit të ditës Shqyrtimi i propozim Vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm pjesën e parcelës P-71513005-00524-4, në fshatin Krushë e Madhe, konstatoj se në mënyrë unanime aprovohet pika e 6 e rendit të ditës, kalojmë në pikën e 7 të rendit të ditës.

7. Shqyrtimi i propozim Vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm pjesën e parcelës P-71510056-00034-0, në fshatin Opterushë.

Afrim Oruqi- Faleminderit Kryesues, ka të bëjë me zonën kadastrale në Opterushë është pronë në menaxhimin e Agjencionit Pyjor të Kosovës, ka të bëjë me zonën tek Kryqi i Opterushës që sot janë ngritur lapidarët e dëshmorëve të kombit “Xhelal Hajda- Toni” dhe “Selajdin Mullabazi- Mici” ne prej kësaj zone kemi incizuar diku rreth 60 ari dhe qëllimi dhe arsytimi është i njëjtë si për propozimin e mëhershëm është mirëmbajtja rregullimi dhe ruajtja e këtyre vendeve , ftoj kuvendarët pas diskutimit ta votojnë dhe ta përkrahin propozim vendimin e Kryetarit, ju faleminderit.

Besmire Bytyçi – Unë e përshëndes këtë iniciativë mirëpo është për mua shumë e pakuptimtë se si ngritën lapidarët e dëshmorëve që kanë rënë në luftën e fundit ndërsa në kadastër emri dhe adresa e këtyre vendeve është e shkruar në gjuhën serbe por propozoj dhe mendoj që ne duhet të marrim iniciativë që këto emra të ndryshohen, nuk mundemi me e ngrit një përmendore të Tonit dhe Micit në Opterushë e aty shkruan, nuk di ta lexoj ju e keni lexuar ndoshta, mendoj që duhet të ndërmarrim hapa konkret në këtë çështje.

Florije Boshnjaku- Jemi në përkrahje gjithmonë për këto iniciativa vetëm se këtu ku është të ngritja e lapidarëve të dëshmorëve unë mendoj që është mirë të jetë ngritja e lapidarëve të Heronjve sepse këta dy janë Heronjtë të Kosovës.

Kryesuesi- E qesim në votim pikën e 7 të rendit të ditës, Shqyrtimi i propozim Vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm pjesën e parcelës P-71510056-00034-0, në fshatin Opterushë, konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e 7 e rendit të ditës, kalojmë në pikën e 8 të rendit të ditës.

8. Shqyrtimi i propozim vendimit për formimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokal.

Kryesuesi- Kuvendi duhet të i propozojë dhe ti ketë 3 anëtarë, ekzekutivi 2, shoqëria civile 1 dhe një përfaqësues nga fshati ose vendbanimi, kjo pasi që komisionet fillojnë punën tek secili fshat që do të shkojnë aty edhe do të zgjidhet një përfaqësues nga fshati, gjithsej ky komision duhet ti ketë 7 anëtarë, tani pra do të fillojmë me propozime për tre anëtarë nga Kuvendi, fillojmë së pari me grupin parlamentar nga radhët e PDK-së dhe pastaj vazhdojmë me subjektet tjera me radhë.

Rasim Fazliu- Faleminderit z. Kryesues, ne grupi parlamentar i PDK-së për anëtarë të komisionit për zgjedhjen e këshillave lokal edhe kryetarëve të fshatrave propozojmë z. Rexhep Oruqi.

Ali Morina- Faleminderit z. Kryesues, ne grupi parlamentar i AAK-së dhe NISMA për anëtarë të komisionit për zgjedhjen e këshillave lokal propozojmë profesorin e nderuar z. Afrim Berisha.

Vahid Krasniqi- Faleminderit z. Kryesues, ne grupi parlamentar i LDK-së për anëtarë të komisionit për zgjedhjen e këshillave lokal propozojmë z. Faton Ramadani.

Kryesuesi- Dy anëtarët e propozuar nga ekzekutivi janë: Saranda Sallteku dhe Përparim Krasniqi, kurse një anëtar nga shoqëria civile duhet të jetë nga SHL-Kosova

Kryesuesi- E qesim në votim pikën e 8 të rendit të ditës Shqyrtimi i propozim vendimit për formimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokal, pasi që i kemi edhe emrat e propozuar, po i lexoj me radhë: z. Rexhep Oruqi- PDK, z. Afrim Berisha- AAK dhe NISMA, z. Faton Ramadani- LDK, ekzekutivi janë: Saranda Sallteku dhe Përparim Krasniqi, dhe një anëtar nga shoqëria civile - SHL-KOSOVA , e qesim në votim pikën e 8 të rendit të ditës, konstatoj se me shumicë votash aprovohet pika e 8 e rendit të ditës.

9. Shqyrtimi i propozim vendimit për ndihmë financiare për z. Bajram Popaj.

Kryesuesi- Ne kemi pranuar një kërkesë për ndihmë financiare nga z. Bajram Popaj i cili ka nevojë për ndihmë për shkak që ka një sëmundje bukur të rëndë i cili ka kërkuar ndihmë nga Komuna.

Vahid Krasniqi- Faleminderit z. Kryesues, pasi që e kam marrë materialin kam parë që këtë vit ne kemi pasur dy raste pak a shumë të ngjashme rasti i parë ka qenë për një rast për ti dalur në ndihmë në fshatin Patoqan dhe rasti i dytë është pra për z. Bajram Popaj që ka një sëmundje, ne jemi këtu për të i ndihmuar çdo kujt që ka nevojë, por në momentin që kam pranuar materialin unë jam interesuar të pyes edhe familje të

tjera ku kam arritur të i kontaktoj 4 familje të cilat nuk e kanë asnjë pension bile një familje është me ndihmë sociale djali ju vuan nga një sëmundje e cila nuk shërohet këturi dhe ai nuk ka mundësi të sigurojë mjete financiare për shërim jashtë vendit, dhe tash pyetja ime është sikur këto familje të na drejtohen të gjitha me kërkesa për ndihmë a do të mund të ballafaqohemi a do të mund të ju ndihmojmë të gjitha këtyre familjeve për ndihmë mjekësore, nuk jam kundër këtij rasti unë jam për ta ndihmuar por sikur të na drejtohen të gjithë me kërkesa atëherë a do të kemi buxhet për të ju ndihmuar të gjitha këtyre familjeve?

Kryesuesi- Është obligim i yni që kërkesat të cilat adresohen tek ne sa të mundemi të ju dalim në ndihmë.

Rasim Fazliu- Unë mendoj që duhet ta përkrahim kërkesën e të nderuarit z. Bajram Popaj për shumë arsye, e para është se është një njeri që ka dhënë shumë për Kosovën e lirë në të cilën jetojmë ne sot, është një çlirimtar, rasti i është paraqitur pra vuan nga një sëmundje e rëndë e keqe dhe është mirë ti dalim në ndihmë këtij dhe shumë të tjerëve sepse kemi pa zgjidhur edhe shumë raste pajtohem me kolegun edhe nuk duhet të bëjmë seleksionime ne duhet të ju dalim në ndihmë të gjithë qytetarëve por theksova z. Bajram Popaj që mendoj se duhet të i dalim në ndihmë, ky e ka kërkesën për 4000€ ndërsa propozim vendimi që është sjellë edhe në KPF Kryetari dhe Drejtori i Financave na ka thënë që kaq para kemi mundësi të i ndahen për ndihmë pra vlera në shumën prej 3000€ po të kishim mundur ti ndanim edhe më shumë do të ishte më mirë por këta e dinë më mirë sepse këta e kanë arkën, në qoftë se nuk kanë më tepër atëherë le të mbetet 3000€, ne si grup parlamentar i PDK-së pajtohem që z. Bajram Popaj të i ndahet shuma e cekur në vendim pra 3000€.

Ali Zhuniqi- Bacën Bajram e njoh edhe personalisht, trajtohet në institucionin ku unë punoj të gjitha këto duke përfshirë analizat, biopsitë, bronkioskopitë, doktori e din d.m.th kanë një kosto jashtëzakonisht të lartë sidomos të kësaj natyre të sëmundjes edhe vërtetë në disa raste është e papërballueshme, unë bacën Bajram zakonisht e ndihmoj, e njoh si njeri shumë parimor padyshim që vlerat e luftës që i ka ai e bëjnë një njeri edhe më shumë që meriton të ndihmohet por duke pasur parasysh parimin e bacës Bajram mirë që ka kërkuar ndihmë por në momentin kur ka bërë kërkesë tek Kryetari i Komunës, Kryetari të Komunës është dashur të i shkojë në mendje se janë edhe shumë pacientë të tjerë të cilët vuajnë nga kjo sëmundje dhe që ne vazhdimisht i kemi në trajtim, jam për të i ndihmuar absolutisht por për 5 pacientë që unë i kam këtu e kemi znj. Isma nuk dua tash të i përmend edhe me emra për shkak të privatësisë të pacientit, e kemi z. Hoti në Ratkoc të gjitha padyshim janë sëmundje shumë të rënda, e kemi z. Duraku në Krushë të Madhe, kemi edhe një tjetër z. Popaj nga Fortesa i cili sapo ka filluar trajtimin, prej rasteve më të ndjeshme i cili mua më ka prekur personalisht shumë është një i ri 15 vjeçar i cili vjen nga fshati Sopniq i cili nuk ka as të ardhura d.m.th nuk ka as pension as kurrigjë dhe kur e shoh që jepet ndihma në këtë formë në këtë aspekt unë nuk pajtohem, në momentin kur bacë Bajram e ka bërë kërkesën Kryetari të Komunës me automatizëm është dashur të i shkojë në mendje bile së paku Albinit 15 vjeçar është dashur të i dilet në ndihmë, në një rast kur kanë dashur ta sjellin për kimio-terapi në vitin 2017 personalisht e kam takuar babin e Albinit nuk ka pasur para as për derivate për ta sjellë deri në QKUK edhe kisha kërkuar si propozim që kjo shumë të ju ndahet të gjithëve sidomos Albinit, ne nuk jemi kundër vlerave të luftës që bacë Bajrami i ka dhënë në luftë, kanë dhënë edhe shumë këtu nuk dua që të i përmend me emra por jemi kundër kësaj forme mënyrës se si ka kërkuar së paku bile Albinit 15 vjeçar është dashur të i ndihmohet.

Dervish Qadraku- Kur është fjala për ndihmë mjekësore të z. Popaj mendoj që janë dy arsye që duhet të i ndihmojmë këtij njeriu, është ana humane dhe ana jonë morale dhe njerëzore për të i ndihmuar, është mirë të i ndihmojmë secilit që ka nevojë për ndihmë materiale për aq sa lejon buxheti ynë i varfër komunal, nga ana morale është ajo se z. Bajram Popaj është një prej ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës i cili nën emblemën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e ka pasur në dispozicion jetën e tij nëse ka qenë nevoja prandaj kjo meritë e tij e cila është shprehur gjatë luftës dhe pas luftës për lirinë e atdheut d.m.th është ana jonë morale që duhet të i rrimë afër dhe të i ndihmojmë materialisht për aq sa kemi mundësi prandaj ne si Lëvizje e përkrahim këtë edhe mundësisht nëse keni mundësi edhe të tjerëve që paraqiten me kërkesa për ndihmë materiale të ju ndihmohet me aq sa kemi mundësi prandaj askujt nuk duhet të i ndalet e drejta dhe mundësia për të bërë kërkesa sepse Komuna në fund të fundit është me buxhetin e qytetarëve dhe për qytetarët prandaj

unë jam që të i ndihmohet për shumën e kërkuar por në fund të fundit ju e dini sesa keni mundësi materiale, ju faleminderit.

Sali Sallteku- Unë e di që qytetarët e Komunës së Rahovecit kanë nevojë për këto por zotëria në fjalë që e ka bërë këtë kërkesë unë e njoh edhe familjarisht ka pasur probleme edhe me gruan dhe nuk është ardhur për të bërë kërkesë për dikë tjetër por vetëm personalisht për veten ka bërë edhe mos ta zgjasim sepse e meriton të ja japim këto edhe unë konsideroj që çka do që flasim dhe të i përmendim edhe raste të tjera veç koritemi sepse ka shumë por hajde të ja kryejmë, kjo është shumë minimale për z. Bajram Popaj ka nevojë edhe për më shumë sepse unë e di që ka pasur fatkeqësi edhe me gruan më duket se tash e ka më mirë por nuk është ardhur për të kërkuar ndihmë, ka pasur edhe fatkeqësi tjera, kështu që hajde të votojmë e të i ndihmojmë aq sa kemi mundësi, ju faleminderit.

Florije Boshnjaku- Unë pajtohem me parafolësit që kanë shqetësime për të gjithë qytetarët e Komunës ne jemi për të gjithë qytetarët mirëpo gjithmonë kur paraqitet kërkesa individuale ne e shqyrtojmë kërkesën individuale, është mirë që në të ardhmen të kemi edhe një plan konkret për të gjitha rastet që paraqiten, mirëpo e ceku edhe parafolësi që z. Popaj ka pasur rastin edhe me bashkëshorten dhe nuk ka ardhur për të kërkuar ndihmë por duke parë që tash gjendja po shkon duke u rënduar edhe shpenzimet janë shumë të mëdha unë mendoj që duhet ta përkrahim, dashtë zoti ky rast të jetë i fundit por edhe aty ku kemi nevojë ne kemi dëshirë të ju ndihmojmë dhe të ju japim përkrahje, ju faleminderit.

Kryesuesi- E qesim në votim pikën e 9 të rendit të ditës . Shqyrtimi i propozim vendimit për ndihmë financiare për z. Bajram Popaj, konstatoj se në mënyrë unanime aprovohet pika e 9 e rendit të ditës, kalojmë në pikën e 10 të rendit të ditës.

10. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm të parcelës P – 71510057-02240-1.

Afrim Oruqi – Faleminderit z. Kryesues, kemi të bëjmë me zonën kadastrale në Rahovec pikërisht tek epopeja e UÇK-së është pronë shtetërore në menaxhim komunal , në menaxhimin e Agjencionit Pyjor të Kosovës , në fletën poseduese figuron mbi 70ha, prej 70ha ne e kemi kufizuar, incizuar dhe kemi ndarë projekt propozim prej 7ha që qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm të kësaj zone është në interes të përgjithshëm publik për ndërtimin e stadiumit për futboll, fushë për hendboll, fushë për voleyboll, fushë për tenis dhe pjesë tjera përcjellëse, ftoj kuvendarët që pas shqyrtimit ta përkrahin dhe ta votojnë propozim vendimin, ju faleminderit.

Rasim Fazliu- Gjithsesi që ne edhe këtë pikë propozim vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm për ndërtimin e stadiumit të futbollit e përkrahim mirëpo desha drejtorin ta pyes a është ndonjë gabim këtu se po shkruan 770ha a është gabim apo si është janë këto hektarë apo jo, mirë ne grupi parlamentar i PDK-së pajtohemi për këtë pikë dhe nuk duam ta zgjasim më tepër.

Vahid Krasniqi- Unë desha vetëm një sqarim tek kjo pikë edhe pika e radhës që vjen zona kadastrale më duket qysh po e shoh është e njëjtë vetëm numri i parcelës po ndryshon, tek pika e radhës parcela a është në këtë zonë kadastrale? Edhe kjo është në menaxhimin pyjor, unë mesa e di që Komuna e pyjeve nuk e ka një status të rregullt dhe gjithmonë pretendohet që këto i menaxhon AKP-ja nuk e di tash ju e dini më mirë, ajo është punë e juaja pasi që tash ka kaluar në kuvend, ju faleminderit.

Ali Morina- Faleminderit z. Kryesues në emër të grupit i japim mbështetje të plotë këtij vendimi.

Fehmi Cena- Në emër të grupit parlamentar të LDK-së e mbështesim këtë vendim meqenëse është në interes të përgjithshëm për Komunën tonë, për qytetin dhe të gjithë.

Dervish Qadraku- Edhe grupi ynë po ashtu pajtohet për ti dhënë mundësinë kësaj parcele.

Nënkryetari- Vetëm një sqarim rreth asaj, me pronat e ekonomisë së pyjeve menaxhon Agjencia pyjore e Kosovës një agjenci në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë edhe këto prona të ekonomisë së pyjeve i menaxhon ajo titullar , pronar është Komuna e Rahovecit mirëpo menaxhimin e bën Agjencia e Pyjeve, ajo tjetra pastaj është që i ka në menaxhim AKP-ja është diçka tjetër një organ tjetër.

Kryesuesi- E qesim në votim pikën e 10 të rendit të ditës, Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm të parcelës P – 71510057-02240-1, konstatoj se në mënyrë unanime aprovohet pika e 10 e rendit të ditës, kalojmë në pikën e 11 të rendit të ditës.

11.Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm të parcelës P – 71510057-02247-0.

Afrim Oruqi- Kemi të bëjmë me zonën e njëjtë d.m.th kjo zonë kadastrale është në Rahovec, kjo pronë ka mbetur në mes të asaj zone të 7ha tash po bëhet fjalë për pjesën 02247-0 është pronë komunale është tek epopeja e UÇK-së është në mesin e atyre 7ha d.m.th 7+ 24ha, qëllimi është i njëjtë shpalljen e interesit të përgjithshëm për investim të qëndrueshëm me interes të përgjithshëm publik për ndërtim të stadiumit për futboll, fushë për hendboll, fushë për volejboll, fushë për tenis dhe pjesë tjera përcjellëse, ftoj kuvendarët që pas shqyrtimit ta përkrahin dhe ta votojnë propozim vendimin, ju faleminderit.

Kryesuesi- E qesim në votim pikën e 11 të rendit të ditës, Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm të parcelës P –71510057-02247-0, konstatoj se në mënyrë unanime aprovohet pika e 11 e rendit të ditës, kalojmë në pikën e 12 të rendit të ditës.

12.Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit për aprovimin e listës së anëtarëve të zgjedhur të Këshillit të Fshatit Hoçë e Madhe.

Munib Durguti- I nderuar Kryesues, të nderuar kuvendarë siç e dini me vendim të Kuvendit me rastin e formimit të komisionit Ad-Hoc për zgjedhjen e kandidatëve për këshillin e Hoçës së Madhe jemi caktuar unë dhe z. Masar Popaj, me kërkesën e z. Masarit unë kam bërë edhe një raport mbi bazën e ecurisë për kandidatët të cilët kanë aplikuar që të jenë anëtarë të këtij këshilli, pas emërimit të komisionit nga ana e KK me vendim numër 17/16 të datës 30.05.2018 komisioni Ad-Hoc në përbërje të plotë me qëllim të shqyrtimit të aplikacioneve të kandidatëve për Këshillin e Fshatit Hoçë e Madhe ka mbajtur mbledhjen dhe ka shqyrtuar të gjitha aplikacionet të cilat kanë arritur në adresë të Kuvendit Komunal, në fillim është konstatuar se në adresë të zyrës së Kuvendit kanë arritur gjithsej 13 aplikacione, 6 prej tyre nga komuniteti shqiptar dhe 7 nga komuniteti serb, në vijim ne ju prezantojmë emrat e kandidatëve sipas numrit të protokollit që kanë arritur në zyrën e Kuvendit , fillojmë me 6 kandidatët nga komuniteti shqiptar: Esat Jaha, Gardalin Shtavica, Ardian Limanaxhiu, Nexhmedin Sopaj, Nahit Elshani, Hatmane Sada , ndërsa nga komuniteti serb janë këta Miroslav Mollitasheviç, Nemanja Çubonoviç, Aleksander Miciç, Sima Spasiç, Biljana Nakallamiç, Nenad Stasiç, Bojan Povlloviç. Fillimisht është bërë shqyrtimi i 7 aplikacioneve të komunitetit serb ku gjatë shqyrtimit të aplikacioneve është shqyrtuar që Nenad Stasiç, Bojan Povlloviç, Nemanja Çubonoviç i plotësojnë kriteret që të jenë anëtarë të Këshillit të Fshatit Hoçë e Madhe dhe me pëlqim të komisionit këta 3 emra janë dërguar sërish në Këshillin e Fshatit Hoçë e Madhe në mënyrë që të bëhet përzgjedhja përfundimtare e tyre në përputhje me nenin 8 të udhëzimit administrativ 11/2014 pra ky nen e rezervon këtë kompetencë pas shqyrtimit nga ana e komisionit fjalën e fundit e jep Këshilli i Fshatit Hoçë e Madhe për kandidatë nga komuniteti pakicë, ne si komision Ad-Hoc duke u bazuar në mandatin e përcaktuar në nenin 7 të udhëzimit administrativ për përzgjedhjen e Këshillit të Fshatit Hoçë e Madhe në dosjet e ofruara nga ana e kandidatëve, CV-të siç janë përgatitja profesionale, përvoja institucionale si dhe atributet tjera personale të kandidatëve mbi bazën e këtyre kriterëve është bërë edhe radhitja e këtyre kandidatëve si në vijim: Esat Jaha, Nahit Elshani, Gardalin Shtavica, Hatmane Sada , Ardian Limanaxhiu, Nexhmedin Sopaj, pra kjo ka qenë radhitja në bazë të përvojës që ne kemi gjetur në CV-të e kandidatëve. Fillojmë me secilin kandidat- Esat Jaha – profesioni i diplomuar në fakultetin e gjeografisë 32 vite përvojë pune në arsim, 7 vite Kryetar Komune nga viti 2000-2007 dhe 4 vite anëtar Këshillit të Fshatit Hoçë e Madhe, ne nuk jemi fokusuar tek përvojat që kanë sjellë nga sektori privat por jemi fokusuar në përvojat që këta kandidatë kanë pas në ushtrimin e funksioneve publike, pra në institucione publike, Nahit Elshani- profesioni ekonomist i diplomuar, përvojë pune si inspektor i të hyrave komunale duke filluar nga viti 1987-1990 në drejtorinë e atëhershme të të hyrave në Rahovec, 1 vit ka ushtruar funksionin e profesorit në gjimnazin e atëhershëm Ramiz Sadiku në Rahovec, 7 vite Nënkyetar i Komunës së Rahovecit 2000-2007, 3 vite këshilltar për çështje ekonomike dhe juridike në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim 2008-2011, 7 vite Këshilltar i

Kuvendit Komunal mandati i parë 2007-2009, dhe mandati i dytë 2009-2013, 4 vite Kryesues i Kuvendit Komunal 2014-2017 po ashtu në vitin 2014 ka qenë anëtar i Komisionit Qeveritar për hartimin e udhëzimit administrativ për themelimin dhe zgjedhjen e Këshillit të Fshatit Hoçë e Madhe, Gardalin Shtavica-profesioni i diplomuar në fakultetin ekonomik aktualisht vijon studimet Master në këtë drejtim, 6 muaj përvojë punë në Korporatën energjetike të Kosovës në divizionin për komunikim, 2 vite ka ushtruar detyrën e Drejtorit të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit, Hatmane Sada- e diplomuar në fakultetin ekonomik vijon studimet master, përvoja e punës institucionale është kjo 4 vite ka punuar në Kuvendin Komunal Rahovec pra si asistente e Kryesuesit të Kuvendit 2014-2017 ndërsa dy kandidatët tjerë në dosjet e tyre nuk kanë ofruar fare përvojë pune ata janë; Nexhmedin Sopaj i diplomuar në master në drejtimin e historisë dhe Ardian Limanaxhiu i diplomuar bachelor në drejtimin e historisë, pas shqyrtimit të këtyre aplikacioneve të kandidatëve duke u bazuar në kushtet e përcaktuara me ligjin për fshatin Hoçë e Madhe udhëzimin administrativ numër 11/2014 dhe shpalljes publike nga ana e Kuvendit Komunal kandidatët të cilët më së shumti i plotësojnë kushtet për të qenë anëtarë të Këshillit të Fshatit Hoçë e Madhe sipas nivelit të përgatitjes profesionale, përvojës së punës institucionale dhe njohuritë eventuale në ruajtjen e trashëgimisë kulturore ne si komision ad-hoc njëzëri u pajtuam si në vijim : Esat Jaha, Nahit Elshani, Nenad Stasiç, Bojan Povllloviç dhe Zvezdan Niçiç i deleguari i kishës ortodokse serbe, andaj ju propozojmë Kuvendit që ta aprovojë listën e plotë të kandidatëve të përzgjedhur nga ana e Komisionit, ju faleminderit.

Rasim Fazliu – Unë po flas në emër të grupit parlamentar të PDK-së ne e kemi shqyrtuar këtë çështje edhe e kemi vlerësuar shumë punën e komisionit dhe i falënderojmë shumë për punën që kanë kryer por pamundësia është që të shkojnë më tepër kandidatë atëherë komisioni ka vlerësuar drejtë këta dy kandidatë po flas për shqiptar, z. Esat Jaha dhe z. Nahit Elshani i kanë plotësuar kushtet më mirë edhe kanë përvojë më tepër kështu që në emër të grupit parlamentar të PDK-së jemi që kjo listë të shkojë komplet edhe për 3 kandidatët serb, d.m.th e përkrahim listën definitive që propozimin definitiv që e ka dhënë komisioni, ju faleminderit.

Florije Boshnjaku- Falënderoj komisionin për punën që ka kryer dhe raportin që ka sjellë, plotësisht pajtohem edhe me parafolësin në lidhje me z. Esat Jaha dhe z. Nahit Elshani sepse e njohin këtë lëmi, kanë punuar edhe mendoj që do të japin një kontribut, mirëpo pyetja ime është tek komisioni a duhet të respektohet barazia gjinore në këtë këshill apo jo? Mos po na kthehet ky propozim, bile së paku nga komuniteti serb kanë mundur ta sjellin një grua nga fshati Hoçë e Madhe, nëse nuk duhet atëherë unë e përkrahi plotësisht këtë listë definitive, ju faleminderit.

Vahid Krasniqi- Faleminderit z. Kryesues, unë plotësisht pajtohem me eliminimin e këtyre dy kandidatëve z. Ardian Limanaxhiu, z. Nexhmedin Sopaj për shkak të përvojës së tyre të cilën nuk e kanë pas në CV, por përderisa dy kandidatët z. Gardalin Shtavica, z. Hatmane Sada i kanë plotësuar kushtet kur jemi tek udhëzimi administrativ neni 7 ku thotë të dërgohet lista e përzgjedhur e kandidatëve për aprovim në Kuvend, unë mendoj se këta dy kandidatë është dashur të jenë në listë pastaj kuvendi të votojë, në qoftë se këta dy nuk janë në listë atëherë nuk ka nevojë të sillen në Kuvend fare por shkojnë direkt pa votuar hiç, mendoj se këta dy është dashur të jenë në listë sepse i kanë plotësuar kushtet si kandidatë pastaj Kuvendi të vendosë se kush do zgjidhet, ju faleminderit.

Fehmi Cena- Edhe unë mesa e di në mbledhjen e kaluar kur i kemi përzgjedhur këta dy anëtarë për këtë komision kemi kuptuar se ata kanë për detyrë të bëjnë përzgjedhjen e të gjithë atyre që kanë konkurruar për këshill dhe që i plotësojnë kushtet, emrat e tyre me i qit në Kuvend dhe ne të i votojmë, fjalën e fundit duhet ta thotë Kuvendi se ne e zgjedhim Këshillin e jo komisioni ai mundet me dalë me rekomandim por nëse ne nuk pajtohemi atëherë e fundit të jetë zgjedhja me propozime nga Kuvendi, kuptohet për ata anëtarë të cilët i kanë plotësuar kushtet konform konkursit.

Ali Morina- Në emër të grupit parlamentar të AAK-së ne e mbështesim listën e emrave të cilën e ka sjellë komisioni Ad-hoc të cilin e kemi angazhuar ta kryejë këtë punë dhe besojmë në punën e këtij komisioni, ju faleminderit.

Kryesuesi- Faleminderit z. Morina, e nderuara znj. Boshnjaku kërkoj një sqarim rreth kuotës gjinore lidhur me pjesëmarrjen në këshillin e fshatit Hoçë e Madhe, për këtë ndoshta mund të na jap një sqarim z. Isak Hoti shef i zyrës ligjore.

Isak Hoti- Përshëndetje Kryesues, Nënkryetar, Delegatë të nderuar atëherë ne duhet të bëjmë një dallim mes konkursit dhe emërimeve në Kuvend, ne e kemi emëruar një komision për ti përzgjedhur këta kandidatë, këtu ka qenë konkurs, në konkurs aplikojnë femra dhe meshkuj tash në këtë rast kandidatët të cilët i kanë plotësuar kushtet kanë qenë meshkuj dhe nuk është faji ynë nëse nuk i kanë plotësuar kriteret të na kthehet nga Ministria, sa i përket kandidatëve që tha z. Cena ti qesim në votim edhe njëherë, nuk mund të bëhet votim mbi votim, ne e kemi votuar komisionin, komisioni e ka pasur për detyrë në bazë të vendimit të cilin e kemi nxjerrë me datën 30.05.2018 me numër 17/67 dhe kemi dhënë kështu detyra dhe përgjegjësi konform këtij vendimi, kemi thënë kështu komisioni ad-hoc ka për obligim që duke u bazuar në legjislacionin në fuqi të shqyrtojë kërkesat e kandidatëve që kanë konkurruar për këshillin e fshatit Hoçë e Madhe, detyrat e komisionit ad-hoc sipas nenit 7 të udhëzimit administrativ janë kështu: Të verifikojë a është bërë aplikimi brenda afatit kohor, të verifikojë a i plotësojnë kandidatët kriteret e seleksionimit, të informojë kandidatët për pranimin ose mospranimin e tyre sipas kriterëve, të dërgojë listën e përzgjedhur dhe të miratuar të kandidatëve për aprovim në Kuvend, kjo vlen edhe për serb por edhe për dy kandidatët të cilët i zgjedh Kuvendi d.m.th ne jemi brenda me ligjin edhe nuk ka nevojë të bëjmë vendim mbi vendim sepse ju keni marrë vendim njëherë ja keni dhënë besimin komisionit, komisioni i ka përzgjedhur dhe ka sjellë emrat e këtyre dy kandidatëve nuk ka nevojë edhe njëherë të shkohet në votim është e pakuptimtë, ju faleminderit.

Kryesuesi- E qesim në votim pikën e 12 të rendit të ditës Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit për aprovimin e listës së anëtarëve të zgjedhur të Këshillit të Fshatit Hoçë e Madhe, konstatoj se me 16 vota për, 1 kundër dhe 9 abstenime aprovohet pika e 12 e rendit të ditës.

Ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë, mirupafshim në mbledhjet e radhës.

Mbledhja e kuvendit ka përfunduar në ora 15:45

01 Nr.2210
Rahovec, 26.07.2018

Procesmbajtësi

Skender Hamza



KRYESUESI

Afrim Dina